NOA SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024
(ME RAPORTIN E AUDITUESIT TE PAVARUR)

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR i-iii
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar 1
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse 2
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë 3
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital 4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM 5
2. BAZAT KONTABËL DHE PËRGATITJA E PASQYRAVE FINANCIARE 6
3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE 6
4. STANDARTE TË REJA APO TË RISHIKUARA OSE INTERPRETIME 6
5. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL 7
5. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM) 8
6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR 20
   (a) Struktura e administrimit të rrezikut 20
   (b) Rreziku i kredisë 21
   (c) Rreziku i likuiditetit 28
   (d) Rreziku i tregut 29
   (e) Rreziku operacional 33
   (f) Administrimi i kapitalit 34
7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE 35
8. TË ARDHURAT NGA INTERESAT 38
9. SHPENZIME PËR INTERESA 38
10. TARIFA DHE KOMISIONE, NETO 39
11. HUMBJA NGA PROVIZIONI I HUAVE DHE PARADHËNIE VETË KLIENTËVE 39
12. TË ARDHURA TË TJERA 39
13. SHPENZIME PERSONELI 40
14. SHPENZIME OPERATIVE TË TJERA 40
15. TATIMI MBI FITIMIN 40
16. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET ME TO 42
16. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET ME TO (VAZHDIM) 43
17. HUA INSTITUCIONEVE FINANCIARE 43
17. HUA INSTITUCIONEVE FINANCIARE (VAZHDIM) 43
18. HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE, NETO 44
18. HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE, NETO (VAZHDIM) 45
19. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE AKTIV ME TË DREJTË PËRDORIMI 47
20. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË PATRUPËZUARA 48
21. AKTIVE TË TJERA 48
22. GRANTE 49
23. HUA 49
24. BORXH I VARUR 50
25. DETYRIME TË TJERA 50
26. KAPITALI I PAGUAR 51
27. REZERVA LIGJORE 51
28. REZERVA E KËMBIMIT 51
29. INTERESAT JO-KONTROLLUESE 52
30. PALËT E LIDHURA 53
31. ANALIZA E MATURITETIT TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE 53
32. ANGAZHIME DHE DETYRIME TE KONSTATUARA 54
33. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT 54

Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Sami Frasheri",
Kompleksi T.I.D, Shk. F, Floor 1
1001 Tirana
Albania

T +355 44 525 880
E contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Noa Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Noa Sh.a' (më tej referuar si"Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2024 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. në jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, në ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. në gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë proçedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupit të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne identifikojmë gjatë proçesit të auditimit.

Grant Thornton Sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

05 qershor 2025

Kleolian Kodra, FCA

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA

NOA SH.A.

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

(Shumat në mijë lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	967,776	833,276
Hua institucioneve financiare	17	343,039	(3,263)
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	18	10,803,216	8,859,172
Inventari dhe aktive të tjera	21	135,792	155,782
Tatim fitimi i parapaguar		-	2,103
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	19	294,803	286,348
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	31,183	17,786
Aktive të shtyra tatimore	15	33,904	27,796
Totali i aktiveve		**12,609,713**	**10,179,000**
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet			
Grante	22	22,528	12,762
Tatim fitimi i pagueshëm	15	11,182	-
Detyrime të tjera	25	342,332	314,744
Hua	23	9,099,841	7,020,175
Borxh i varur	24	494,921	493,201
Totali i detyrimeve		**9,970,804**	**7,840,882**
Kapitali			
Kapitali i paguar	26	731,838	731,838
Rezerva ligjore	27	73,184	73,184
Rezervat e konvertimit	28	(5,241)	2,022
Fitime të mbartura		1,814,060	1,522,562
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		**2,613,841**	**2,329,606**
Interesa jo-kontrollues	**29**	**25,068**	**8,512**
Totali i kapitalit		**2,638,909**	**2,338,118**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**12,609,713**	**10,179,000**

Pasqyra e konsoliduar e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitur nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 54 dhe që janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.

NOA SH.A.

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

(Shumat në mijë lekë)

	Shënime	*Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor* 2024	2023
Të ardhura nga interesat	8	2,505,138	1,857,788
Shpenzime për interesa	9	(764,761)	(524,640)
Të ardhura neto nga interesat		**1,740,378**	**1,333,148**
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	10	196,711	136,768
Shpenzime për tarifa dhe komisione	10	(2,908)	(3,088)
Tarifa dhe komisione neto		**193,803**	**133,680**
Rimarrja nga kreditë e fshira	11	95,183	94,511
Te ardhura nga shitje portofoli		-	25,972
Të ardhura të tjera	12	20,538	18,025
Të ardhura operative neto		**2,049,902**	**1,605,336**
Shpenzime personeli	13	(629,435)	(505,495)
Shpenzime operative të tjera	14	(270,536)	(239,431)
Humbje nga provizioni i huave dhe paradhënieve për klientët	11	(440,010)	(271,057)
Shpenzime zhvlerësimi	19	(113,979)	(99,475)
Shpenzime amortizimi	20	(13,275)	(9,337)
Humbja neto nga kursi i këmbimit		4,461	(535)
Shpenzime totale operative		**(1,462,775)**	**(1,125,330)**
Fitimi para tatimit		**587,127**	**480,006**
Tatimi mbi fitimin	15	(89,607)	(78,504)
Fitimi për vitin		**497,520**	**401,502**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		**497,520**	**401,502**
Totali i fitimit per :			
Zoteruesit e njesise ekonomike meme		500,611	409,539
Interesat e pakices		(3,091)	(8,037)
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per :		500,611	409,539
Zoteruesit e njesise ekonomike meme		(3,091)	(8,037)
Interesat e pakices			

Pasqyra e konsoliduar e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 54 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

NOA SH.A.

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	Shënime	2024	2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi për vitin para taksës		**587,127**	**480,007**
Rregullimet për:			
Shpenzime zhvlerësimi	18	113,979	99,474
Shpenzime amortizimi	19	13,275	9,337
Shpenzimi financiar për detyrimet e qirasë		13,090	11,055
Humbje nga nxjerrja nga përdorimi i aktiveve		-	-
Humbje nga zhvlerësimi i kredive ndaj klientëve	10.1	440,010	271,057
Humbjet neto nga kursi i këmbimit		(8,688)	41,079
Të ardhura nga interesa	7	(2,505,138)	(1,863,211)
Shpenzime për interesa	8	751,671	520,504
Ndryshime në			
Hua dhe paradhënie klientëve		(2,401,385)	(2,225,300)
Hua institucioneve financiare		(334,219)	108,826
Aktive të tjera		6,283	(65,987)
Detyrime të tjera		34,162	85,793
		(3,289,833)	**(2,527,366)**
Interes i arkëtuar		2,472,531	1,814,979
Interes i paguar		(717,321)	(512,613)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(82,464)	(100,676)
Mjetet monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ, neto		**(1,617,088)**	**(1,325,676)**
Flukset e parasë nga aktivitete investuese:			
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	18	(43,814)	(73,688)
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	19	(14,516)	(9,016)
Mjete monetare të përdorura në aktivitetet investuese, neto		**(58,329)**	**(82,704)**
Flukset e Parasë nga aktivitete financuese:			
Hyrje nga huatë	5f	5,267,187	3,572,627
Pagesa nga huatë	5f	(3,179,368)	(2,149,268)
Ripagimet e detyrimeve të qirasë		(76,167)	(70,113)
Hyrje nga obligacionet		-	493,201
Hyrje nga grantet		9,766	12,762
Dividendë të paguar	24	(210,767)	(199,570)
Hyrje nga emetimi i kapitalit NCI		16,669	16,549
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financuese, neto		**1,827,319**	**1,676,187**
Rritje te mjeteve monetare dhe ekuivalente me to, neto		151,902	267,807
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	15	**833,276**	**608,745**
Diferencë neto nga kursi i këmbimit		(17,402)	(43,276)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	15	**967,776**	**833,276**

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 54 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

NOA SH.A.

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

(Shumat në mijë lekë)

	Kapitali Aksionar	Rezerva Ligjore	Rezerva e konvertimit	Fitimet e Mbartura	Totali	NCI	Totali
Gjendja me 1 Janar 2023	**731,838**	**73,184**	**-**	**1,312,593**	**2,117,615**	**-**	**2,117,615**
Fitimi për vitin	-	-	**2,022**	**409,539**	**411,561**	**8,512**	**420,074**
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	**2,022**	**409,539**	**411,561**	**8,512**	**420,074**
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Dividendë	-	-	-	**(199,570)**	**(199,570)**	-	**(199,570)**
Totali i transaksioneve me pronarët e Grupit	-	-	-	**(165,695)**	**(156,538)**	-	**(156,538)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2023	**731,838**	**73,184**	**2,022**	**1,522,562**	**2,329,606**	**8,512**	**2,338,119**
Fitimi për vitin	-	-	-	500,611	**500,611**	(3,091)	**497,520**
Diference nga konvertimi NCI	-	-	(7,263)	1,654	**(5,609)**	3,906	**(1,703)**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	**(7,263)**	**502,265**	**495,002**	**815**	**495,817**
Transaksione me pronarët e Grupit							
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Emetim kapitali	-	-	-	-	-	15,741	**15,741**
Dividendë	-	-	-	(210,767)	**(210,767)**	-	**(210,767)**
Totali i transaksioneve me pronarët e Grupit	-	-	-	**(210,767)**	**(210,767)**	**15,741**	**(195,026)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2023	**731,838**	**73,184**	**(5,241)**	**1,814,060**	**2,613,841**	**25,068**	**2,638,909**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara u miratuan nga drejtimi i Shoqërisë më 30 maj 2025 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Herjola Spahiu
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

Ariola Çela
Drejtor Ekzekutiv i Financës

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 54 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. Informacion i përgjithshëm

NOA SH.A (referuar si "NOA" ose "Grupi"), është një Shoqëri aksionare shqiptare e vendosur në Tiranë, e cila vepron në fushën e kredisë për individë dhe shoqëri të vogla dhe të mesme. Grupi eshte i zotëruar tërësisht nga Tranzit sh.p.k.,(i zotëruar më tej nga fonde investimi të menaxhuara nga Moscopole INC me perfitues fundor Z. Andi Ballta, New Century Holdings XI, L.P dhe NCH Balkan Fund, L.P.) një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron mundësi financimi për shoqëritë dhe individët.

NOA ka filluar aktivitetin e saj në 1999 si PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredi) dhe më vonë si Opportunity Albania, në 2010 aksionet e Grupit u blenë nga NOA Holdings N.V, një entitet i huaj i themeluar në Hollandë. Në 2011, emri i Grupit u ndryshua nga Opportunity Albania në NOA SH.A.

NOA Holding N.V me numër regjistrimi 33268765 me seli në Strawinskylaan 569, 1077 XX, Amsterdam, Holandë është në pronësi 100% nga NOA Cooperatief U.A numër regjistrimi 34379979 me seli në Strawinskylaan 569, 1077 XX, Amsterdam, Holandë. NOA Cooperatief U.A zotërohet 51,67% nga BFSE Holding B.V dhe 48,33% nga Creation Investments Social Venture Fund I.

Ne date 31 Dhjetor 2024 NOA Holdings N.V dhe NOA Cooperatief U.A shiti 100% te aksioneve te NOA sh.a tek Tranzit sh.p.k.

NOA SH.A. udhëhiqet nga Këshilli i Administrimit dhe Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë. Me date 31 Dhjetor 2024 ne mbledhjen e askionareve u miratua doreheqja e Anetareve te meparshem te Keshillit te Administrimit, te cilet u zevendesuan me anetaret e rinj si me poshte, per nje periudhe 3 vjecare:

U Miratua emërimi për një periudhë trevjeçare të anëtarëve të rinj të Këshillit Administrimit:

1. Kristin Lia Giantris Kryetari i Këshillit
2. Herjola Spahiu, Zv / Kryetar
3. Fatos Beqja; Anëtar
4. Jason George; Anëtar
5. Mirton Lika. Anëtar

Drejtimi Ekzekutiv përbëhet nga Administratori i Shoqërisë dhe Grupi i Drejtuesve kryesorë.

Më 31 dhjetor 2024, Grupi operon në 31 pika shitje (2023: 30) të vendosura në të gjithë vendin duke ofruar shërbimet e saj përmes 369 punonjësve (2023: 349 punonjës). Zyrat qëndrore të NOA janë në Tiranë Shqipëri, të regjistruara në adresën "Rruga Tish Daia", pranë Komunës së Parisit, "Kompleksi Haxhiu" (Kika 2), Pallati nr. 2, Kati 1, Tiranë.

NOA SH.A zotëron 60% të aksioneve të I.F.J.B NOA SH.A Kosovë. I.F.J.B NOA SH.A është regjistruar më 10 tetor 2022 në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me numer unik 811987968 dhe ka marrë nga Banka Qendrore e Kosovës licencën si institucion financiar jo-bankar në Kosovë më 27 shkurt 2023, me numer license IFJB/084 duke filluar veprimtarine operacionale ne 13 qershor 2023.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përfshijnë Kompaninë dhe filialin e saj, dhe së bashku referohen si 'Grupi' e individualisht si 'Entitetet e Grupit'.

2. Bazat kontabël dhe përgatitja e pasqyrave financiare

2.1 Bazat kontabël

Këto Pasqyra Financiare te konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare te konsoliduara janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

2.3 Llogarite e Grupit

Grupi u krijua më 10 tetor 2022 përmes hapjes së një filiali të ri në Kosovë nga NOA Sh.A.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare te konsoliduara paraqiten në Lek Shqiptar ("LEK"), e cila është edhe monedha funksionale e Grupit. Të gjitha shifrat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

4. Standarte të reja apo të rishikuara ose interpretime

Standarte dhe interpretime te reja të cilat janë efektive

- Klasifikimi i pasiveve si korente ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)

Standarte dhe interpretime te reja të cilat nuk janë ende efektive

Shoqëria nuk ka adoptuar më herët ndonjë standard të ri, interpretim apo ndryshim që është nxjerrë por nuk është ende efektiv në këto pasqyra financiare te konsoliduara.

- Mungesa e shkëmbimit (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshim në SNRF 9 e 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese'

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye nuk janë dhënë informacione shpjeguese.

5. Politikat materiale kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Grupi për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në monedhën funksionale në kurset e këmbimit në datat të transaksioneve. Aktivet monetare dhe detyrimet në valutë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, nëse ka, përkthehen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit ne datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Elementët e tjerë jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj përkthehen në kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj njihen në fitim ose humbje.

Operacionet e huaja
Në pasqyrat financiare të Grupit, të gjitha aktivet, detyrimet dhe transaksionet e njësive të Grupit që kanë përdorur tjetër monedhe funksionale nga LEK, janë përkthyer në LEK pas konsolidimit. Monedhat funksionale të njësive brenda Grupit kanë mbetur të pandryshuara gjatë periudhës raportuese.
Në konsolidim, asetet dhe detyrimet janë përkthyer në LEK me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet kanë janë përkthyer në LEK me normën mesatare gjatë periudhës raportuese. Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit e prej konvertimeve janë ngarkuar dhe kredituar në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithpërfshirëse dhe të njohura në rezervën e përkthimit të monedhës në kapital.

(b) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë e drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt të drejtojë politikat financiare dhe operacionale të një entiteti, në mënyrë që të sigurojnë përfitime nga aktivitetet e tij. Në vlerësimin e kontrollit, merren parasysh të drejtat e mundshme të votës që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Bazuar në kërkesat ligjore lokale dhe kërkesat e mbikëqyrjes Grupi është i detyruar të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara. Këto pasqyra financiare të konsoliduara konsolidojnë aktivitetin e filialit.

Pasqyrat financiare të filialeve përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data e fillimit të kontrollit deri në datën që kontrolli pushon. Kur Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai çregjistron aktivet dhe detyrimet e filialit dhe çdo interes të lidhur jo-kontrollues dhe përbërës të tjerë të kapitalit neto. Çdo fitim ose humbje që rezulton njihet në fitim ose humbje.

Balancat dhe transaksionet brenda grupit, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet e parealizuara që rrjedhin nga transaksionet brenda grupit, eliminohen në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Interesat në filiale

Të përcaktuara më poshtë janë detajet e filialeve të mbajtura drejtpërdrejt nga Grupi:

Filiali	*Vendi i themelimit dhe vendi kryesor i biznesit*	*Aktiviteti kryesor*	*Proporcioni i interesave të pronësisë nga Grupi në fund të periudhës*
I.F.J.B NOA Sh.a	Kosove	Sherbime financiare	60%

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(c) Interesat e pakices

NCI maten fillimisht me pjesën e tyre proporcionale të aktiveve neto të identifikueshme në datën e blerjes. Ndryshimet në interesin e Grupit ndaj filialit që nuk rezultojnë në humbjen e kontrollit, janë kontabilizuar si transaksione të kapitalit.

(d) Humbja e kontrollit

Kur Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai cregjistron aktivet dhe detyrimet e filialit, dhe cdo interes jo-kontrollues të lidhur dhe komponentët e tjerë të kapitalit neto. Cdo fitim ose humbje që ndodh, njihet ne fitim ose humbje, Cdo interes I mbajtur mbi filialin matet me vlerën e drejtë, kur kontrolli është humbur.

(e) Transaksionet e eleminuara ne konsolidim

Balancat dhe transaksionet brenda grupit, dhe të ardhurat dhe shpenzimet e parealizuara që vijnë nga transaksionet brenda grupit, eleminohen në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuara eleminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por vetëm në atë masë sa nuk ka prova zhvlerësimi.

(f) Të ardhura/ shpenzime nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje bazuar në metodën efektive te interesit. Norma efektive e interesit është norma që skonton arkëtimet dhe pagesat e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar

- vlerën bruto të mbetur të aktivit financiar ose
- kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë përllogaritjes së normës efektive të interesit për instrumentet financiarë të ndryshëm nga aktivet e blera ose aktive te gjeneruara te zhvlerësuara, Grupi vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo ECL. Për aktivet financiare të blera ose aktivet e gjeneruara te zhvlerësuara, llogaritet norma efektive e interesit të rregulluar nga zhvlerësimi i kredisë duke përdorur flukset monetare të ardhshme duke përfshirë dhe ECL.
Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifat e transaksionit dhe njësitë e paguara ose të pranuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

Norma efektive e interesit llogaritet me njohjen për here te pare të aktivit financiar ose detyrimit financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit llogaritet mbi vlerën bruto të mbetur të aktivit (kur aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose me koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si rezultat i rivlerësimit periodik të flukseve të monetare të instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(f) Të ardhura/ shpenzime nga interesi (continued)

Grupi llogarit të ardhurat e interesit nga aktivet financiare, të tjera nga ato qe janë konsideruar si të zhvlerësuara, duke përdorur normë efektive interesi (NEI) mbi vlerën bruto të mbetur të aktivit financiar.
Kur një aktiv financiar ka humbje te vlerës se kredisë (siç është përcaktuar në shënimin 5g (vii) dhe për më tepër është në Klasën 3, Grupi llogarit të ardhurat nga interesi duke përdorur NEI në vlerën neto të amortizimit të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar rregullohet "rikuperohet" (siç është përshkruar në shënimin 5g (vii)) dhe nuk është me e kategorizuar si kredi e vonuar, Grupi ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesi ne vlerën bruto.
Llogaritja e të ardhurave nga interesi duke përdorur metodën efektive te interesit përfshin interesat nga aktivet të matura me kosto të amortizuar; shpenzimet e interesit përfshijnë interesin nga detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar.

(g) Tarifa dhe komisione

Grupi krijon të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një shumëllojshmëri shërbimesh financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në atë masë që pasqyron shumën për të cilën Grupi pret të ketë të drejtë të marrë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e marrjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kur Grupi ofron një shërbim për klientët e saj, shërbimi faturohet përgjithësisht pas përfitimit të menjëhershëm të shërbimit të ofruar në datën e caktuar ose në fund të kontratës për një shërbim të ofruar për një periudhë te caktuar kohore.

Të ardhura nga tarifat ndahen në kategoritë e mëposhtme:

Të ardhura nga tarifat e shërbimeve financiare kur përmbushja e detyrimeve të performancës është e kënaqshme në një moment të caktuar:

- *Tarifat e Brokerimit*: Grupi vepron si ndërmjetës për shitjen e kontratave të sigurimit në emër të Grupit së sigurimit dhe merr një komision fiks për çdo transaksion. Detyrimi I Grupit është të ekzekutojë marrëveshjen në emër të Grupit së sigurimit dhe të ardhurat njihen pasi të kryhet çdo marrëveshje (në datën e marrëveshjes). Pagesa e komisionit kryhet në fund të muajit. Pagesa e komisionit zakonisht bëhet në datën e transaksionit
- *Tarifa të tjera*: I referohet verifikimit të kredisë sipas kërkesës së klientit. Tarifat e marra në këmbim të këtyre shërbimeve njihen në momentin e kryerjes së transaksionit pasi klienti merr vetëm përfitimet e performancës së Grupit vetëm pas përfundimit të suksesshëm të transaksionit kryesor. Grupi ka të drejta mbi tarifën vetëm pas përfundimit të transaksionit.

Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Shpenzime të tjera për tarifa dhe komisione që lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve dhe jo me dhënien e kredive ndaj klientëve, shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(h) Qiratë

Grupi si qiramarrës

Qiratë të cilat nuk i transferojnë kompanisë konsiderueshem të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e pajisjeve të dhënë me qira janë qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Regjistimi i pagesës së qirasë njihet si shpenzim në periudhën në të cilën ka ndodhur. Stimujt e qirasë së marrë njihen si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së qirasë.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(e) Qiratë (vazhdim)

Grupi zbaton një njohje dhe model matjeje të vetme për të gjitha qiradhëniet përveçse qirave afatshkurtra dhe qirave me aktiv me vlerë të vogël. Grupi njeh detyrimet e qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve në fjalë.

Aktiv me të drejtë përdorimi

Grupi njeh aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto duke zbritur amortizimin apo humbjet nga zhvlerësimi duke u rregulluar me çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin totalin e detyrimeve te qirasë të njohur, kostot direkte fillestare të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, duke e pakësuar me çdo stimul të qirasë të marre. Aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Afatet e qirasë sipas ndarjeve janë si vijon: Ndërtesa - nga 2 deri në 5 vjet, Automjete – 4 vjet.

Aktivet me të drejtë përdorimi janë paraqitur në shënimin 19 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi.

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Grupi njeh detyrimet e qirasë, të matura në vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të kryhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (minus çdo stimul të arkëtueshëm), pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, dhe shumat që pritet të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje në mënyrë të arsyeshme që do të ushtrohet nga Grupi dhe pagesa të gjobës për ndërprerjen e qirasë, nëse qiraja reflekton ushtrimin e opsionit për të përfunduar. Pagesat e bëra të qiradhënies operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të përgjithshëm të qirasë, gjatë afatit të qirasë. Detyrimet e qirasë paraqiten nën zërin detyrime të tjera.

(i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në humbje ose fitim përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe penalitetet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe aktivet e* Kushtëzuara.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të merret, i cili reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë kompensuar (netuar) vetëm nëse plotësohen disa kritere.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimore.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që të realizohet përfitim fiskal; Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

5. Politika materiale kontabël (vazhdim)

(i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen për aq sa është e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme të cilat kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Grupi pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Grupi fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet në datën kur ato krijohen.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën e tregtimit, në të cilën Grupi është palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për çdo njësi jo pjese e vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes , kostot e transaksionit janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tyre.

(ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar, vlerën e drejte nëpërmjet te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse ose vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar sime vlerën e drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes :

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilit është mbajtja e aktivit për tu arkëtuar: dhe flukset kontraktuale monetare dhe kushtet kontraktuale të aktivit financiar të cilat lindin në datat specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI).

Instrumentet e borxhit të matshme si me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet dhe nuk janë përcaktuar si vlerën e drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes:

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilit është arritja njëkohësisht mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare;
- dhe kushtet kontraktuale të aktiveve financiare të cilat lindin në një datë specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit SPPI.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital i cili nuk mbahet për qëllime tregtimi, Grupi mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme të paraqesë ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në OCI; Këto zgjedhje janë bërë në bazë të investimeve të njëpasnjëshme.

Të gjitha aktivet e tjera janë klasifikuar dhe matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Vlerësimi e modelit të biznesit

Në vlerësimin e objektivit të modelit të biznesit, Grupi konsideroi informacionin e mëposhtëm:

- Politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe veprimet e tyre në praktikë, duke përfshirë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në krijimin e të ardhurave nga interesi kontraktual;
- Mënyra e vlerësimit dhe raportimit të performancës së portofolit tek drejtuesit e Grupit;
- Rreziku qe ndikon performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura sipas atij modelit të biznesit) dhe si këto rreziqe menaxhohen; dhe
- Frekuencën e pritshme te shitjeve ne vlerën dhe kohë

Qasja e modelit të biznesit është bazuar në mënyrë të arsyeshme në skenarët e pritshëm pa marrë "skenarin më të keq" apo "skenarin nën stres" në llogaritje. Nëse flukset e mjeteve monetare, pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë që ndryshon nga pritshmëritë fillestare të Grupit, Grupi nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo krijuara ose te blera.

Grupi klasifikon aktivet e veta financiare duke u bazuar në modelin e biznesit, mbajtur për tu arkëtuar.

(iv) Njohja dhe matja fillestare

Vlerësimet nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit, Grupi konsideron termat kontraktuale dhe Instrumentet. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban terma kontraktual të cilat mund të ndryshojnë kohen ose shumen e flukseve hyrëse aq sa mund te mos përmbushë këtë kusht.

Për qëllime të këtij vlerësimi "Principali" është përcaktuar me vlerën e drejtë të aktivit financiar në njohjen fillestare. "Interesi" është përcaktuar si vlera në kohë e parasë për këtë rrezik të lidhur me shumën e papaguar të principalit në një periudhë të caktuar duke përfshirë rrezikun bazë të kredisë dhe kostot (p.sh. rrezikun e likuiditetit dhe kostot administrative) gjithashtu edhe marzhet e fitimit. Të gjitha aktivet financiare kane kaluar testin SPPI(pagesa të vetme të Principalit dhe interesit) dhe aktivet financiare janë njohur me vlerë të mbetur.

(v) Riklasifikimi

Aktivet financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveçse në periudhën pasi Grupi ndryshoi modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Nuk ka klasifikime të ndodhura gjatë vitit 2024 dhe 2023.

(vi) Çregjistrimi

Grupi çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë së aktivit financiar. Interesi nga aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Grupi njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Në çregjistrimin e një aktivi financiar diferenca midis shumës së mbartur të aktivit (ose shumës së mbartur të shpërndarë sipas pjesës së aktivit të çregjistruar) dhe shume se (i) konsiderueshme për tu marrë (përfshirë çdo aktiv të ri të marrë duke zbritur detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo të ardhur ose humbje te akumuluar e cila është e njohur në OCI, njihet në fitim ose humbje.

Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Grupi kryen transaksione me anë të të cilave transferon aktivet të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse mbarten të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një përqindje totale aktuale të shkëmbimit të kthimit mbi aktivet e transferuara, transaksioni llogaritet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Grupi as nuk mbart dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ajo çregjistron aktivin nëse e humbet kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vete sipas rastit si aktive ose detyrime. Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, Grupi vazhdon të njohë aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

(vii) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera e tyre paraqitet neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm, dhe vetëm, nëse Grupi ka të drejtë ligjore t'i kompensojë dhe ka qëllim që të shlyejë në baza neto ose të fitojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetëm kur kjo lejohet nga standardet e kontabilitetit ose kur ato shkaktohen nga një grup i ngjashëm transaksionesh si për shembull nga aktiviteti i Grupit.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt provizioni.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm në princip midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, ose në mungesë të saj, në tregun më të favorshëm në të cilin Grupi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një aktivi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Grupi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për një aktiv ose detyrim ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Grupi përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave të mbikëqyrura dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Treguesi më i mirë i vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të arkëtuar. Nëse Grupi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna të njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit.

Në vijim, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

Grupi mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e metodës së mëposhtme:

- Niveli 1: Çmimi I tregut në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknikat e vlerësimit bazuar në inputet e vëzhguara. Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuara sipas: çmimit të tregut në një treg aktiv për një instrument të ngjashëm, çmime tregu për instrumente të ngjashëm në tregje të cilat konsiderohen më pak se aktive ose teknika të tjera

  vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të matshme në mënyre direkte ose indirekte nga tregu.
- Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke përdorur inpute të rëndësishme të pakontrollueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet kur teknikat e vlerësimit përfshijnë inpute jot ë bazuara në të dhënat e mbikëqyrura dhe inputet e pakontrolluara mund të kenë një efekt domethënës në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuara për instrumente të ngjashme, kur kërkohen rregullime apo supozime të konsiderueshme të pa kontrollueshme për të pasqyruar ndryshimet midis instrumenteve

(vii) Zhvlerësimi

Grupi njeh një fond për humbje i cili është i barabartë me jetëgjatësinë e ECL në instrumentet financiare, të cilat janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

- aktive financiare të cilat janë instrumente borxhi

Grupi mat humbjen në një vlerë të barabartë me ECL përgjatë gjithë jetës se aktivit, përveçse në rastet për të cilat ato maten si ECL 12 mujore:

- investime në letra më vlerë të cilat kanë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit dhe
- instrumente të tjera financiare (të tjera nga të arkëtueshme nga qiraja financiare) në të cilin rreziku nuk është rritur në mënyrë të rëndësishme që në momentin e njohjes.

ECL12-mujore është ajo pjesë e ECL që rrjedh nga ngjarjet e mospagesës së një instrumenti financiar të cilat janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Instrumentet financiare për të cilat njihet një ECL12 mujore quhen 'Instrumentet financiare të Klasës 1'. ECL përgjatë gjithë jetës është ECL që rrjedh si rezultat i të gjitha ngjarjet te mundshme të mospagesave te paracaktuara gjatë jetës së instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet ECL përgjatë gjithë jetës, por që nuk janë kredi zhvlerësuara referohen si 'Instrumentet financiare të Klasës 2'.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Matja e ECL

ECL është vlerësim i humbjeve të kredisë me probabilitet të ponderuar. Ato maten si më poshtë:

- Aktivet financiare të cilat nuk janë zhvlerësuar në datën e raportimit si vlera aktuale mjeteve monetare të munguara (psh.diferenca midis flukseve monetare të cilat i detyrohen njësisë ekonomike bazuar mbi kontratat dhe flukseve monetare qe Grupi pret të marrë)
- Aktivet financiare të cilat janë të zhvlerësuara në datën e raportimit: si një diference midis shumës bruto të mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme te vlerësuara monetare. Inputet kryesore për matjen e ECL janë struktura baze PD, LGD dhe variablat EAD. Informacione të zgjeruara se si janë përllogaritur janë të detajuara në shënimet e rrezikut financiar 6.b.ii)

Paraqitja e fondit të ECL-në pasqyrën e pozicionit financiar

Fondi i humbjes se kredisë ECL është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë: aktivet financiare të matura me koston e amortizuar i zbritur nga vlera bruto e mbartur e aktiveve.

Fshirjet nga pasqyrat financiare

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e një aktivi financiar në tërësinë ose një pjesë të tij. Kjo zakonisht ndodh kur Grupi përcakton se huamarrësi nuk ka aktive ose burime të ardhurash të cilat gjenerojnë flukse të mjaftueshme monetare për të shlyer shumat të cilat janë subjekt i fshirjes. Ky vlerësim bëhet për çdo aktiv individualisht. Shumat e rimarra nga fshirjet e mëparshme paraqiten veçantë në "Fitimi neto nga rimarrja e kredive dhe paradhëniet e klientëve" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Aktivet financiare të cilat janë fshirë mund të jenë subjekt i veprimeve përmbarimore në përputhje me procedurat e Grupit për rikuperimin e kredive.

Përcaktimi i mospagesës

Grupi e konsideron një aktiv financiar te zhvlerësuar apo në Klasën 3(kredi e zhvlerësuar)për përllogaritjen e ECL në të gjitha rastet kur huamarrësi është 90 ditë në vonesë në pagesat e tij sipas kontratës.

Evidenca objektive të zhvlerësimit

Si pjesë e vlerësimit sasior, nëse një klient është në mospagesë, Grupi konsideron një tërësi rastesh të cilat mund te tregojnë dëshirë për mospagesë. Në çdo datë raportimi, Grupi vlerëson nëse aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar janë kredi te zhvlerësuara (referuar si 'Aktivet financiare të Klasës 3'). Një aktiv financiar është kredi e zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar . Fakti që një aktiv financiar është kredi jo performuese përfshin të dhënat vijuese:

- vështirësi të theksuara financiare të huamarrësit
- prishje e kushteve te kontratës si mospagesë ose rezultat i një ngjarjeje të ndodhur ne te kaluarën
- një ristrukturim i kredisë në terma që Grupi do të konsideronte ndryshe
- është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar; ose
- një hua që është rinegociuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes së huamarrësit zakonisht konsiderohet të jetë kredi jo performuese nëse nuk ka dëshmi se rreziku i mosmarrjes së flukseve monetare kontraktuale është reduktuar ndjeshëm dhe nuk ka indikatorë të tjerë të zhvlerësimit.

Është në politikën e Grupit që të përcaktojë nëse një instrument financiar i devijuar është "kuruar" dhe për më tepër është klasifikuar jashtë Klasës 3/Klasës 2, kur nuk ka asnjë indikacion për zhvlerësim për minimalisht 9 muajt te njëpasnjëshëm.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(j) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Kredi të ristrukturuara

Grupi në disa raste kryen modifikime të kushteve origjinale të kredisë si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend qe të marrë në posedim ose të zbatojë mbledhjen e kolateralit. Grupi e konsideron një kredi të ristrukturuar kur këto modifikime vijnë si rezultat i pamundësisë financiare të huamarrësit dhe Grupi nuk do të kishte rënë dakord me këto rregullime nëse huamarrësi do të ishte financiarisht i shëndetshëm. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë mos-pagime sipas marrëveshjes, ose shqetësime të konsiderueshme ngritur nga Departamenti i Riskut të Kredisë. Devijimi mund të përfshijë zgjatjen e marrëveshjes së pagesave dhe marrëveshje dhe kushteve të reja të kredisë. Me rinegocimin e kushteve të reja, matet provigjoni duke përdorur normën efektive te interesit te përllogaritur përpara modifikimit të kushteve të kredisë. Është politika e

Grupit për të monitoruar kreditë e ristrukturuara e për të ndihmuar që pagesat e ardhshme të jenë të sigurta të ndodhin.

Vendimi i çregjistrimit dhe klasifikimi midis Klasës 2 dhe 3 janë përcaktuar rast pas rasti. Nëse kjo procedure identifikon një humbje në lidhje me një kredi, e cila është përcaktuar dhe menaxhuar si e provigjonuar "Klasa 3", aktivi është i ristrukturuar derisa sa mblidhet ose fshihet.

Grupi çregjistron një aktiv financiar, të tilla si kredi dhe paradhënie ndaj klientëve, kur janë rinegociuar afatet dhe kushtet për shtyrje, në thelb behet kredi e re, ndryshimi njihet si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën ne të cilën humbja nuk është regjistruar. Kreditë e reja të njohura klasifikohet si Klasa 1 e ECL për qëllime matjeje përveç nëse kredia konsiderohet POCI. Kur vlerësohet një kredi për një klient nëse duhet të çregjistrohet apo jo, përmes faktorëve cilësorë, Grupi konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshime në monedhën e kredisë
- Ndryshime në maturitet për më shumë se 50%;
- Ndryshime në palët e kontratës
- Nëse ndryshimet në instrument nuk përputhen me kriterin SPPI

Kur kredia është rinegociuar ose modifikuar por jo çregjistruar, Grupi rivlerëson nëse ka patur një rritje të rëndësishme në rrezikun e kredisë. Grupi gjithashtu vlerëson nëse kredia duhet të klasifikohen si Klasa 3.

Një herë që aktivi është klasifikuar si i devijuar, do të mbetët i tillë për një periudhe minimalisht 9 mujore si një periudhë prove. Në mënyrë që kredia të klasifikohet jashtë kategorisë së kredive të ristrukturuara, klienti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Pas të gjitha lehtësimeve duhet të konsiderohet kredi performuese.
- Periudha e provës prej 9 muajsh ka kaluar nga data kur kontrata e ristrukturuar është konsideruar performuese.
- Pagesa të rregullta te principalit dhe interesit janë bërë gjatë gjysmës së dytë të periudhës së provës.
- Klienti nuk ka asnjë kést ne më shumë se 30 ditë vonesë.

(k) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet tre mujor ose më të vogël, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Grupi në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(l) Hua dhe paradhënie

Grupi mat "Hua institucioneve financiare","Huatë dhe paradhëniet e klientëve" dhe investimet e tjera financiare me kosto të amortizuar nëse të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Një aktiv financiar është mbajtur sipas modelit të biznesit me objektiv: për të mbajtur aktivin financiar në mënyre që të mbledhë flukset kontraktuale monetare.
- Kushtet kontraktuale të aktivit financiar përcaktojnë datat e flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI) në shumën mbetur të papaguar.

Huatë dhe paradhëniet e klientëve maten me kosto të amortizuar, ato maten fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte shtesë të transaksioneve dhe më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv,

(m) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.
Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Kur pjesë të ndryshme të një aktivi të qëndrueshëm të trupëzuar kanë jetëgjatësinë të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (pjesët kryesore të tyre). Aktivet me të drejtë përdorimi paraqiten së bashku me aktivet afatgjata materiale- referojuni politikes së kontabilitetit në shënimin 5 (e).

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën mbartur të njësisë nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të vijnë në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.
Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Jeta e dobishme për vitin aktual dhe paraardhës është si më poshtë:

Pajisje elektronike	4 vite
Automjete	4 vite
Pajisje dhe mobilje	5 vite
Përmirësime të ambienteve të marra me qira	4 vite

Një njësi ose çdo pjesë fillestare të njohura të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara çregjistrohet nëse asgjësimi (d.m.th., në datën kur marrësi merr kontrollin) ose kur nuk pritet përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi ose asgjësimi i tij. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga çregjistrimi i aktivit (llogaritur si diferenca midis të ardhurave të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të aktivit) përfshihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur aktivi çregjistrohet.
Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(n) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Programet kompjuterike dhe licensat e blera nga Grupi njihen me koston historike të zvogëluar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.
Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.
Amortizimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është 1-2 vjet.

(o) Inventari

Aktivet e tjera janë të përbëra nga aktivet e marra në zotërim nëpërmjet procesit të arkëtimit të huave me probleme, që nuk sjellin qera dhe nuk përdoren nga Grupi dhe kanë si qëllim shitjen në një kohë të shkurtër pa nevojën e një ristrukturimi të rëndësishëm. Aktivet e marra në zotërim maten me vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës së realizueshme neto dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

(p) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.
Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidenca nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël, që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(q) Huatë

Huatë fillimisht maten me vlerën e drejte minus kostot direkte rritëse te transaksionit, më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huamarrjet përmbajnë kushte, të cilat nëse tejkalohen, i bëjnë huamarrjet të ripagueshme sipas kërkesës dhe të klasifikuara si detyrime afatshkurtra, përveç nëse hiqet dorë nga huadhënësi.

(r) Obligacionet

Obligacionet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shuma e marrë është vlerësimi më i rëndësishëm i vlerës së drejtë të obligacioneve.

5. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(s) Grantet

Një grant njihet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ka siguri të arsyeshme se do të merret, dhe se Shoqëria do të përmbushë kushtet e lidhura me të. Grantet që kompensojnë Shoqërinë për shpenzimet e bëra njihen si të ardhura në fitim ose humbje mbi baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat janë kryer shpenzimet. Grantet që kompensojnë Shoqërinë për koston e një aktivi njihen në fitim ose humbje si të ardhura mbi një bazë sistematike gjatë jetës së dobishme të aktivit ose pas përfundimit të kushteve kontraktuale që lidhen me të.

(t) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që të mira ekonomike të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerën e tregut dhe sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

(u) Përfitimet e punonjësve

Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetsore

Grupi paguan kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të cilat sjellin përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të siguruar pragun minimal ligjor për pensionet në Shqipëri nën një plan të përcaktuar pensioni. Kontributet e Grupit për planin e përfitimit të pensionit regjistrohen në humbje ose fitim atëherë kur ndodhin.

Plan pensioni me kontribute të përcaktuara
Detyrimet për planet e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime për personelin në pasqyrën e të ardhurave ne momentin kur ndodhin. Grupi nuk ka asnjë detyrim ligjor për të paguar kontribute përveç kontributeve të saj fikse, të cilat njihen si shpenzim në periudhën kur merret shërbimi nga punonjesit.

6. Administrimi i rrezikut financiar

Grupi është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiarë:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Grupit për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

(a) Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli i Administrimit të Grupit ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Grupi i drejtuesve kryesorë është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikës të administrimit të rrezikut në këto çështje.

Politikat e administrimit të rrezikut të Grupit janë ngritur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Grupi, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të

reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Grupi, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj të administrimit dhe trajnimit, ruan një ambient kontrolli dobisjellës dhe të disiplinuar.

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë

Gjatë veprimtarisë së saj, Grupi ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhënë klientëve, nga fondet e vendosura pranë institucioneve të tjera financiare dhe nga zërat jashtë pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. angazhimet për huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve). Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Grupit nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe nga fondet pranë institucioneve të tjera financiare dhe zërat e tjerë të paregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Grupi konsideron dhe mbledh të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si p.sh rreziku i dështimit të një huamarrësi të veçantë, dhe rreziku i sektorit). Grupi bën paraprakisht vlerësimin e rrezikut të kredisë e cila përfshin pozicionin financiar të debitorit dhe aftësinë e tij paguese. Vlerësimi bëhet nga oficeri i kredisë dhe rishikohet nga njësia e rrezikut të kreditit.

Grupi administron rrezikun e kredisë në mënyrë të vazhdueshme duke monitoruar drejtpërdrejt limitet e kredisë, portofolin e kredisë dhe përqëndrimin e ekspozimit.

(i) Administrimi i rrezikut të kredisë

Këshilli i Administrimit, duke qenë përgjegjës për administrimin dhe monitorimin e rrezikut të kredisë, ka deleguar përgjegjësinë për vendimmarrje lidhur me rrezikun e kredisë tek Komiteti i Kredisë, Komiteti i Rrezikut të Kredisë dhe Departamenti i Rrezikut të Kredisë, përfshirë:

- *Formulimin e politikave të kredisë* në bashkëpunim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat mbi kolateralin, vlerësimin e kredisë, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurat dokumentuese dhe ligjore, dhe pajtueshmërinë me kërkesat statutore.
- *Themelimin e strukturës autorizuese* për aprovimin dhe rinovimin e linjave të kredive nga autoritete të ndryshme brenda Grupit (p.sh., Komiteti i Kredisë).
- *Rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë ndaj klientëve*. Departamenti i Rrezikut të Kredisë së Grupit vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë, të cilat kalojnë limitet e përcaktuara, përpara aprovimit final dhe disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e kredive janë subjekt i të njëjtit proces.
- *Kufizimin e përqëndrimeve të ekspozimit* ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe paradhëniet), emetuesve, limiteve të klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe vendit (për letrat me vlerë të investimit).
- *Zhvillimin dhe mbajtjen e kategorive të rrezikut të Grupit* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare dhe të fokusojë drejtuesit në rreziqet e pritshme. Kategorizimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen provizione për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike të kredive. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut adoptuar në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë, përbëhet nga 5 shkallë, të cilat reflektojnë nivele të ndryshme të rrezikut të mospagimit dhe vlefshmërisë të kolateraleve, ose mundësive të tjera për të zvogëluara rrezikun e kredisë.
- *Vëzhgimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit*, përfshirë ato për industritë e zgjedhura dhe llojeve të produkteve. Raporte 3 mujore mbi cilësinë e kredisë dhe trendeve i dërgohen Komitetit të Kredisë dhe në bazë të tyre merren masa korrigjuese.
- *Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësive të specializuara* ndaj njësive të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira të administrimit të rrezikut të kredisë në të gjithë Grupin.

Çdo njësi biznesi është e detyruar të zbatojë politikat dhe procedurat e kredisë në përputhje me autoritetet aprovuese të deleguara. Përqëndrimi i rrezikut të kredisë i cili vjen nga instrumentet financiare ekziston për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin

që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Shumica e përqëndrimit të rrezikut të kredisë vjen nga lloji i klientit në lidhje me huatë dhënë klientëve nga Grupi.

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut te kredisë

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin maksimal aktual ndaj rrezikut të kredisë për komponentët e aplikueshëm të pozicionit financiar:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Mjetet monetare në bankë (Shënimi 16)	963,783	825,024
Depozita afatshkurtra (Shënimi 16)	392,951	-
Hua ndaj institucioneve financiare (Shënimi 17)	343,039	(3,263)
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve neto (Shënimi 18)	10,803,216	8,859,172
Të arkëtueshme nga palët e treta (Shënimi 21)	28,714	46,806
	12,531,703	**9,727,739**

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe huatë ndaj institucioneve financiare nuk janë me ditëvonesë dhe as të zhvlerësuara.

Grupi paraqet kreditë dhe paradhëniet e klientëve në vlerë neto, pasi vlera e tyre e mbartur më e mirë përfaqëson ekspozimin maksimal bruto të rrezikut të kredisë.

Grupi monitoron nga afër zhvillimin dhe cilësinë e portofolit të kredisë në 5 kategori në bazë të ditë vonesave.

Vlera e mbartur bruto të mjeteve monetare dhe huave dhe paradhënieve për institucionet financiare 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqitet:

	2024				2023			
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total	Klasa 1	Klasa2	Klasa 3	Total
Mjetet monetare në bankë								
1. 0-30 dpd	963,783	-	-	**963,783**	825,024	-	-	**825,024**
Depozita afatshkurtra								
1. 0-30 dpd	392,951			**392,951**	-	-	-	-
Hua ndaj institucioneve financiare								
1. 0-30 dpd	343,039	-	-	**343,039**	(3,263)	-	-	**(3,263)**

Tabela më poshtë tregon EAD për kreditë dhe paradhëniet të klientëve:

	31 Dhjetor 2024			
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Hua dhe paradhënie klientëve				
1. 0-30 ditë vonesë	10,580,447	300,180	383	10,881,010
2. 31-90 ditë vonesë	425	183,072	4,447	187,944
3. 91-180 ditë vonesë	96	0	139,366	139,462
4. 181- 365 ditë vonesë	551	0	256,765	257,316
5. >365 ditë vonesë	0	0	432,917	432,917
Total	**10,581,519**	**483,252**	**833,878**	**11,898,649**

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(ii) Ekspozim ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim)

	31 Dhjetor 2023			
	Klasa 1	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Total**
Hua dhe paradhënie klientëve				
1. 0-30 ditë vonesë	8,710,832	251,534	325	8,962,690
2. 31-90 ditë vonesë	835	120,663	22	121,520
3. 91-180 ditë vonesë	-	-	83,735	83,735
4. 181- 365 ditë vonesë	10	-	166,073	166,082
5. >365 ditë vonesë	-	-	274,009	274,009
Total	**8,711,676**	**372,197**	**524,164**	**9,608,037**

Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet e ECL-s në hua dhe paradhënie të klientëve, hua dhënë institucioneve financiare, mjete monetare dhe ekuivalente për vitin 2024 dhe 2023:

	31 Dhjetor 2024			
	Klasa 1	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Total**
Hua dhe paradhënie klientëve				
1. 0-30 ditë vonesë	57,665	67,074	2,072	126,811
2. 31-90 ditë vonesë	2	27,052	5,682	32,736
3. 91-180 ditë vonesë	1	-	134,534	134,535
4. 181- 365 ditë vonesë	1	-	240,888	240,889
5. >365 ditë vonesë	0	-	432,136	432,136
Total	**57,669**	**94,126**	**815,312**	**967,107**

	31 Dhjetor 2023			
	Klasa 1	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Total**
Hua dhe paradhënie klientëve				
1. 0-30 ditë vonesë	50,635	56,602	325	107,562
2. 31-90 ditë vonesë	4	12,187	22	12,212
3. 91-180 ditë vonesë	-	-	73,185	73,185
4. 181- 365 ditë vonesë	-	-	166,955	166,955
5. >365 ditë vonesë	-	-	274,046	274,046
Total	**50,639**	**68,789**	**514,533**	**633,960**

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(ii) Ekspozim ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet shumen e mbartur bruto të huave dhe paradhënieve të klientëve me kosto të amortizuar më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023:

	2024			
	Klasa 1	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Total**
Shuma e mbartur bruto më 1 Janar 2024	**8,711,677**	**372,197**	**524,164**	**9,608,037**
Aktiv i ri financiar i krijuar	8,578,862	-	-	**8,578,862**
Ripagim të aktiveve	(5,965,076)	(87,854)	(49,434)	**(6,102,365)**
Transferuar në Klasën 1	15,839	(15,839)	-	
Transferuar në Klasën 2	(675,872)	678,210	(2,338)	-
Transferuar në Klasën 3	-	(467,605)	467,605	-
Rikalsifikim	-	6,026	-	**6,026**
Fshirje	-	-	(105,165)	**(105,165)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(83,914)	(1,883)	(950)	**(86,746)**
Më 31 Dhjetor 2024	**10,581,515**	**483,252**	**833,882**	**11,898,649**

	2023			
	Klasa 1	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Total**
Shuma e mbartur bruto më 1 Janar 2023	**6,876,657**	**189,814**	**460,248**	**7,526,718**
Aktiv i ri financiar i krijuar	7,198,007	326	-	**7,198,333**
Ripagim të aktiveve	(4,690,232)	(51,539)	(158,893)	**(4,900,664)**
Transferuar në Klasën 1	(98,353)	38,375	59,978	-
Transferuar në Klasën 2	(469,279)	495,882	(26,603)	-
Transferuar në Klasën 3	-	(297,600)	297,600	-
Fshirje	-	-	(107,403)	**(107,403)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(105,124)	(3,061)	(763)	**(108,948)**
Më 31 Dhjetor 2023	**8,711,676**	**372,197**	**524,164**	**9,608,037**

Në Klasën 3 kreditë me ECL zero ishin kredi të mbuluara plotësisht me kolateral dhe ekspozimi ndaj mospagesave EAD më 31 Dhjetor 2024 ishte 5,279 mijë LEK dhe vlera e kolateralit e skontuar 8,947 mijë LEK (2023: Klasa 3 EAD 8,122 mijë LEK dhe vlera e kolateralit të skontuar 57,340 mijë LEK).

Krahasimi i ndryshimeve në fondin e humbjes se pritshme te kredisë (ECL) sipas klasave të kredive të klientëve është si më poshtë vijon:

	2024			
	Klasa1	**Klasa2**	**Klasa 3**	**Total**
Rezerva e ECL më 1 Janar 2024	**50,639**	**68,789**	**514,533**	**633,960**
Aktiv i ri financiar i krijuar	124,587	-	-	**124,587**
Aktiv financiar i çregjistruar	(23,431)	(605)	(33,769)	**(57,805)**
Transferuar në Klasën 1	95	(95)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(301,398)	301,505	(107)	-
Transferuar në Klasën 3	-	(291,407)	291,407	-
Rimatje neto e humbjes te provizionit	207,856	16,386	149,985	**373,227**
Kredi të fshira	-	-	(105,165)	**(105,165)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(679)	(447)	(572)	**(1,698)**
Më 31 Dhjetor 2024	**57,669**	**94,126**	**815,312**	**967,107**

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(ii) Ekspozim ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim)

	2023			
	Klasa1	**Klasa2**	**Klasa 3**	**Total**
Rezerva e ECL më 1 Janar 2023	**69,627**	**25,750**	**454,326**	**549,703**
Aktiv i ri financiar i krijuar	100,491	-	-	100,491
Aktiv financiar i çregjistruar	(21,704)	(3,432)	(123,582)	(148,718)
Transferuar në Klasën 1	(1,042)	307	735	-
Transferuar në Klasën 2	(57,786)	62,751	(4,965)	-
Transferuar në Klasën 3	(159,386)	(20,420)	179,806	-
Rimatje neto e humbjes te provizionit	122,252	14,635	104,152	241,039
Kredi të fshira	(1,565)	(10,495)	(95,343)	(107,403)
Rregullim për kursin e këmbimit	(248)	(307)	(597)	(1,152)
Më 31 Dhjetor 2023	**50,639**	**68,789**	**514,532**	**633,960**

Përmbledhje e kredive të modifikuara dhe të shtyra

31 Dhjetor 2024	**Vlera Kontabël Bruto**	**Klasa II Modifikimet e përhershme nëT&Cs**	**Klasa III Modifikimet e përhershme nëT&Cs**	**Kredi të modifikuara**	**Përqindja e modifikimit**
Detyrime nga Bankat	343,039	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientësh					
Biznes	8,703,200	282,333	46,010	328,343	3.8%
Konsumatore	2,742,806	16,389	5,760	22,149	0.8%
Total Hua dhe paradhënie Klientësh	**11,446,006**	**298,722**	**51,770**	**350,492**	**4.6%**

31 Dhjetor 2023	**Vlera Kontabël Bruto**	**Klasa II Modifikimet e përhershme nëT&Cs**	**Klasa III Modifikimet e përhershme nëT&Cs**	**Kredi të modifikuara**	**Përqindja e modifikimit**
Detyrime nga Bankat	(3,263)	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientësh					
Biznes	7,079,683	230,889	9,622	240,511	3.4%
Konsumatore	2,528,354	8,067	480	8,548	0.3%
Total Hua dhe paradhënie Klientësh	**9,608,037**	**238,956**	**10,102**	**249,059**	**3.7%**

31 Dhjetor 2024	**Vlera kontabël bruto e kredive të shtyra**			**Fondi ECL**		
	Klasa II	**Klasa III**	**Total**	**Klasa II**	**Klasa III**	**Total**
Detyrime nga Bankat	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientësh						
Biznes	282,333	46,010	328,343	69,125	36,100	105,226
Konsumatore	16,389	5,760	22,149	4,216	5,599	9,815
Total Hua dhe paradhënie Klientësh	**298,722**	**51,770**	**350,492**	**73,342**	**41,699**	**115,041**

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përmbledhje e kredive të modifikuara dhe të shtyra (vazhdim)

31 Dhjetor 2023	Vlera kontabël bruto e kredive të shtyra			Fondi ECL		
	Klasa II	Klasa III	Total	Klasa II	Klasa III	Total
Detyrime nga Bankat	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientësh						
Biznes	230,889	9,622	240,511	55,838	8,529	64,367
Konsumatore	8,067	481	8,548	2,050	480	2,530
Total Hua dhe paradhënie Klientësh	**238,956**	**10,103**	**249,059**	**57,888**	**9,009**	**66,897**

Klasa 1 – Rritje e rrezikut të kredisë

- Kredi performuese deri në 30 ditë vonesë dhe qe nuk kane indikacion për devijim.

Klasa 2 – Rritje e rëndësishme e rrezikut të kredisë

Aktivet financiare përformuese janë klasifikuar ose si Klasa 1 ose si Klasa 2.

Aktivet e klasifikuara në Klasën 2 kanë pësuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare. Vlerësimi nëse humbjet e pritura të kredive gjatë gjithë jetës duhet të njihen, bazuar në një rritje të konsiderueshme në jetëgjatësinë ose rrezikun e mospagesës që nga njohja fillestare. Përgjithësisht ekziston një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredidhënies përpara se një aktiv të bëhet një kredi jo performuese ose të ndodhë një fakt. Ky fakt është vendimtar për qëllime të SNRF 9, i cili kërkon të njihen humbjet e pritura në kohë.

Indikatorët qe tregojnë një rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë të cilët klasifikojnë një kredi në Klasën 2 janë si më poshtë vijon:

- Ekspozime të cilat kanë qenë mbi 90 ditë vonesë të paktën një herë në jetëgjatësinë e tyre dhe ose më pak në datën e raportimit
- Ekspozime të cilat janë ristrukturuar. Nëse ekspozimi i ristrukturuar performon për 9 muajt të njëpasnjëshëm transferohet në Klasën I.

Klasa 3 -Kredi jo performuese

- Ekspozime për më shumë se 90 ditë vonesë
- Raste mashtrimi
- Huamarrësi nuk ka mundësi të paguajë, debitori /garantori ka vështirësi të konsiderueshme financiare lidhur me probabilitet falimentimi ose riorganizimeve të tjera financiare; për huamarrësin kanë nisur masat ligjore nga organet shtetërore; probleme të shëndetit të debitorit.

Humbja e pritshme e kredise

Matja e ECL (fondi i humbjes se pritshme te kredise)
Në strukturën e matjes së ECL përfshihen variablat e mëposhtëm:

- probabiliteti i mospagesave (PD)
- humbje nga mospagesat (LGD)
- ekspozimi ndaj mospagesave (EAD)

Ekspozimi i ECL ne Fazën 1 është kalkuluar duke shumëzuar PD e 12 muajve me LGD dhe EAD.
ECL përgjatë jetës është përllogaritur duke shumëzuar jetëgjatësinë e PD me LGD dhe EAD.

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Për llogaritjen ECL të Kosovës, duke qenë se kompania nuk kishte të dhëna historike për llogaritjet e PD dhe LGD, janë aplikuar raportet PD dhe LGD të kredive të ngjashme të portofolit të kompanisë mëmë NOA Shqipëri, PD dhe LGD u përshtat me riskun e Kosovës.

Politika e fshirjes së kredive

Grupi fshin një hua (dhe çdo fond të lidhur për provigjionimin e humbjes) kur Grupi ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore për grumbullimin, e cila është 365 ditë pas:

a) paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e kolateralit në zyrën e përmbarimit kur kredia është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme; ose

b) lëshimi i vendimit të gjykatës në rast se kredia nuk është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme.

Grupi mban kolateral kundrejt një grup huash dhe paradhënie të klientëve në formën e hipotekës mbi pronën, letrat me vlerë të tjera të regjistruara mbi pasuritë dhe garancitë. Kolaterali i hipotekuar përfshin tokë, apartamente, toke bujqësore dhe biznese. Kolateralet e tjera të regjistruara janë prona të luajtshme të cilat përfshijnë vetëm automjete.

Përllogaritja e vlerës së drejtë është bazuar mbi vlerën e drejtë të kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes. Për ekspozime të kredisë mbi 2 milionë Lekë vlerësimi i kolateralit realizohet në baza vjetore. Më 31 Dhjetor 2024 vlera e drejtë e kolateralit të mbajtur ishte 3,840,838 mijë Lek (2023: 3,441,919 mijë Lek; kolaterali i mbajtur i kredive të klasës 3 ishte 49,100 mijë Lek (2023: 165,000 mijë Lek).

Përqëndrimi i rrezikut sipas sektorit

Grupi monitoron përqendrimet e riskut të kredisë nga sektori për kreditë saj dhe paradhëniet për klientët. Një analizë e rrezikut të përqëndrimit të sektorit në datën e raportimit paraqitet më poshtë:

Sektori	31 Dhjetor 2024	%	31 Dhjetor 2023	%
Shërbime	2,243,014	19%	1,826,569	19%
Tregti	2,334,443	20%	1,933,724	20%
Agrikulturë	1,952,338	16%	1,630,516	17%
Përmirësime për shtëpi	396,329	3%	505,885	5%
Prodhim	731,452	6%	561,986	6%
Bare dhe Restorante	893,502	8%	759,945	8%
Transport	303,153	3%	335,381	3%
Të tjera	2,325,126	20%	1,493,675	16%
Hotele	537,619	5%	416,359	4%
Interes i përllogaritur	181,673	2%	143,996	1%
Total	**11,898,649**	**100%**	**9,608,037**	**100%**

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë të Grupit në sektorin financiar është si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2024		31 Dhjetor 2023	
	Monedhë vendase	Monedhë vendase	Monedhë vendase	Monedhe të huaj
Mjetet monetare në bankë	490,276	80,555	755,279	69,745
Depozita afatshkrutra	392,951	-		
Hua institucioneve financiare	343,039	-	(3,263)	-

6. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Grupit mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe veprimeve tregtare. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një entiteti në përmbushjen e detyrimeve për të paguar në mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë. Departamenti i Rrezikut të Kredisë përgatit një analizë rreziku për palën tjetër dhe rekomandon vendosjen e limiteve të palës tjetër për Komitetin e Administrimit të Rrezikut. Komiteti i administrimit të rrezikut aprovon limitet e rrezikut të kundërpartive që përfshin rrezikun direkt dhe rrezikun e shlyerjes.

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi të hasë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare të cilat shlyhen duke dhënë para ose një aktiv tjetër financiar.

(i) Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Politika e Grupit në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kohën e kërkuar si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pa-favorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë emrin e saj. Njësia e Thesarit, merr informacion nga njësitë e tjera të biznesit lidhur me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve të tyre financiare dhe detaje të flukseve të tjera monetare të projektuara të cilat vijnë nga biznesi i ardhshëm i projektuar.

Njësia e Thesarit mban një portofol aktivesh afatshkurtra likuide, të përbërë kryesisht nga Instrumentet e investimit afatshkurtra, hua dhe paradhënie dhënë Shoqërive dhe lehtësi të tjera ndërmjet Shoqërive, për të siguruar mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm të Grupit në tërësi.

Kërkesat e likuiditetit plotësohen nëpërmjet overdrafteve dhe kredive afatshkurtra të marra për të mbuluar ndonjë luhatje afatshkurtër dhe burimeve më afatgjata të fondeve për t'iu përgjigjur kërkesave strukturore të likuiditetit. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit i nënshtrohen rishikimit të Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve ("ALCO"). ALCO gjithashtu administron boshllëqet e përgjithshme të Grupit dhe vendos limite te përshtatshme. Raportet ditore të likuiditetit monitorohen nga Njësia e Thesarit. Grupi monitoron likuiditetin në baza ditore në mënyrë që të administrojë detyrimet në kohën e kërkuar.

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Politikat e brendshme e Grupit parashikojnë që kjo e fundit të mbajë një limit kumulativ të likuiditetit jo më pak se 20% të kapitalit. Grupi mund të investojë maksimumi 100% te fondeve të lira në ndonjë depozitë ose investim afatshkurtër në bankat lokale që kanë kundërparti me limite të aprovuara.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

(iii) Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023, aktivet dhe detyrimet financiare kanë maturitet kontraktual të mbetur :

31 Dhjetor 2024	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	>1vit	Total
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	967,776	-	-	-	967,776
Hua institucioneve financiare	8,361	1,546	391,142	40,476	441,525
Hua dhe paradhënie klientësh neto	394,254	779,003	3,899,403	6,131,608	11,204,268
Aktive të tjera financiare	9,143	-	-	-	9,143
Totali i aktiveve financiare	**1,379,534**	**780,549**	**4,290,546**	**6,172,084**	**12,622,712**
Detyrime financiare					
Grante	-	-	-	22,528	22,528
Detyrime për qira	5,088	10,177	45,796	125,290	186,351
Hua	228,511	573,523	3,158,687	6,168,630	10,129,351
Borxh i varur	-	-	40,000	600,000	640,000
Total i detyrimeve financiare	**233,599**	**583,700**	**3,244,483**	**6,916,448**	**10,978,230**
Pozicioni net	**1,145,934**	**196,849**	**1,046,063**	**(744,364)**	**1,644,482**
Pozicioni kumulativ neto	**1,145,934**	**1,342,783**	**2,388,846**	**1,644,482**	**-**

31 Dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	>1vit	Total
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	833,276	-	-	-	833,276
Hua institucioneve financiare	3,041	-	37,160	3,248	43,449
Hua dhe paradhënie klientësh neto	415,871	816,338	4,111,600	6,358,333	11,702,142
Aktive të tjera financiare	8,265	-	2,069	-	10,334
Totali i aktiveve financiare	**1,260,453**	**816,338**	**4,150,829**	**6,361,581**	**12,589,201**
Detyrime financiare					
Grante	-	-	-	-	-
Detyrime për qira	5,307	10,613	47,759	115,624	179,303
Hua	75,374	482,154	2,699,808	4,448,363	7,705,699
Obligacione	-	-	80,000	592,313	672,313
Total i detyrimeve financiare	**80,681**	**492,767**	**2,827,567**	**5,156,299**	**8,557,315**
Pozicioni net	**1,179,772**	**323,571**	**1,323,262**	**1,205,281**	**4,031,886**
Pozicioni kumulativ neto	**1,179,772**	**1,503,343**	**2,826,605**	**4,031,886**	**-**

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, të tilla si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të huamarrësit/emetuesit), do të ndikojnë në të ardhurat e Grupit apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit

Rreziku i kurseve të huaja të këmbimit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e kurseve të këmbimit. Transaksionet e Grupit gjenerojnë fitime dhe humbje nga kurset e këmbimit të cilat njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Grupit të cilat nuk janë të shprehura në monedhën matëse të saj. Grupi e menaxhon këtë rrezik duke kontrolluar madhësinë e diferencës ndërmjet vlerës së aktiveve në monedhë të huaj dhe detyrimeve në monedhë të huaj.

Kurset e aplikueshme të këmbimit (Lek ndaj njësisë së monedhës së huaj) për monedhat parësore në 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

Ekspozimi i Grupit ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit monitorohet në mënyrë të vazhdueshme duke siguruar përputhshmëri me limitet dhe rregulloret e brendshme të Grupit. Këto limite i referohen një maksimumi prej 20% të pozicionit të hapur në secilën monedhë dhe 30% të pozicionit të përgjithshëm të hapur të monedhës.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 sipas monedhave të huaja në të cilat ato shprehen, ishte si më poshtë (shumat të përkthyera në Lek):

31 Dhjetor 2024	LEK	EUR	USD	Total
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	60,507	879,128	28,141	967,776
Hua institucioneve financiare	0	4,524,753	-	4,524,753
Hua dhe paradhënie klientëve neto	8,740,333	2,062,883	-	10,803,216
Të arkëtueshme nga palët e treta	29,054	(340)	-	28,714
Totali i aktiveve financiare	**8,829,895**	**7,466,424**	**28,141**	**16,324,460**
Detyrimet financiare				
Grante	-	-	22,528	22,528
Detyrime për qira	33,572	152,779	-	186,351
Hua	5,984,613	7,296,943	-	13,281,555
Borxh i varur	494,921	-	-	494,921
Totali i detyrimeve financiare	**6,513,106**	**7,449,721**	**22,528**	**13,985,355**
Pozicioni neto	**2,316,789**	**16,702**	**5,614**	**2,339,104**

31 Dhjetor 2023	LEK	EUR	USD	Total
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	312,937	504,087	16,252	833,276
Hua institucioneve financiare	0	3,382,685	-	3,382,685
Hua dhe paradhënie klientëve neto	7,363,745	1,495,427	-	8,859,172
Të arkëtueshme nga palët e treta	46,283	523	-	46,806
Totali i aktiveve financiare	**7,722,965**	**5,382,722**	**16,252**	**13,121,939**
Detyrimet financiare				
Grante	-	-	12,762	12,762
Detyrime për qira	32,211	147,098	-	179,309
Hua	1,787,190	5,232,985	-	7,020,175
Obligacione	493,201	-	-	493,201
Totali i detyrimeve financiare	**2,312,603**	**5,380,083**	**12,762**	**7,705,447**
Pozicioni neto	**5,410,363**	**2,639**	**3,490**	**5,416,492**

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Informacioni i dhënë dallon nga pasqyra e pozicionit financiar ku huatë ndaj institucioneve financiare në Euro, në shumën 4,181,715 mijë Lek (2023: 3,385,948 mijë Lek) janë kompensuar me balancat e overdraftit të marra nga Grupi nga bankat duke përdorur këto kredi si kolaterale në përputhje me kontratat e kredive respektive dhe në bazë të qëllimit të shlyerjes duke netuar shumat përkatëse.

Analiza e ndjeshmërisë të efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit të mbajtur konstante gjatë gjithë periudhës. Analiza e mëposhtme përllogarit efektet e mundshme të lëvizjes së kursit të këmbimit kundrejt monedhës vendase LEK (të gjithë variablat e tjera janë konstante) në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (për shkak të vlerës së drejtë të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve monetare) dhe kapitalit (nuk ka kapital të veçantë apo instrumente mbrojtëse, të cilat ndikojnë në ndjeshmërinë e kapitalit, rrjedhimisht efekti është I njëjtë si ndjeshmëria e pasqyrës së fitim humbjes.

Një vlerë negative në tabelë paraqet një humbje potenciale neto në fitim ose humbje në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose kapitalit, në pasqyrën e pozicionit financiar një vlerë pozitive reflekton një mundësi rritjeje. Një zvogëlim ekuivalent në secilën nga monedhat më poshtë kundrejt monedhës vendase do të ndikojë në një provigjkt të kundërt ekuivalent.

	100 bp Rritje Paralele	**100 bp Rritje Paralele**	**50 bp Rritje Paralele**	**50 bp Rritje Paralele**
Më 31 Dhjetor 2024	223	(223)	112	(112)
Më 31 Dhjetor 2023	61	(61)	31	(31)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e normave të interesit në treg. Grupi e administron rrezikun e normës së interesit duke monitoruar kushtet e tregut e duke aplikuar çmime të nevojshme, duke u bazuar në analizën e kostos për çdo produkt. Kreditë e dhëna të NOA-s janë me interes fiks dhe shumica e tyre janë me terma më pak se 5 vjet. Huatë e marra nga huadhënësit vendas apo të huaj janë me norma fikse dhe variabël si paraqiten më poshtë. Drejtimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt limitit të hendekut të normës së interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit ndaj skenarëve të ndryshëm të normave. Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj një rritje ose ulje të normave të interesit, duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike në kurbën e kthimit dhe pozicioni financiar qëndron konstant si më poshtë vijon:

	Skenarët deri në një vit		**Skenarët mbi një vit**	
2024	100 bp Rritje	100 bp Zvogëlim	100 bp Rritje	100 bp Zvogëlim
Përllogaritja e efektit në Fitim (humbje)	70,668	(70,668)	(2,310)	2,310
2023				
Përllogaritja e efektit në Fitim (humbje)	62,909	(62,909)	(6,827)	6,827

Informacioni mbi normën efektive

Normat mesatare efektive të kategorive kryesore të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024		**31 Dhjetor 2023**	
	EUR	**EUR**	**EUR**	**LEK**
Aktive				
Hua të arkëtueshme nga institucionet financiare	1.63%	n/a	1.30%	n/a
Hua dhe paradhënie klientësh	21.30%	24.86%	18.70%	24.50%
Detyrimet				
Hua	6.96%	6.35%	6.21%	6.65%
Obligacione		8.51%		8.81%

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të *norm*ës së interesit (vazhdim)

Analiza e ri çmimit të normës së interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e riçmimit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet monetare të Grupit. Aktivet dhe detyrimet me normë të ndryshueshme janë raportuar sipas datës së ardhshme të ndryshimit të normës së interesit. Aktivet me normë fikse interesi janë raportuar sipas datës së skeduluar të ripagimit të principalit.

		31 Dhjetor 2024						
Aktive:	**Norma efektive e interesit**	**Totali**	**Deri ne 6 muaj**	**6 - 12 muaj**	**1 - 2 vjet**	**2 - 5 vjet**	**Me shumë se 5 vjet**	**Jo subjekti i rivlerësimit të interesit**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (Shënimi 16)	-	967,776	967,776	-	-	-	-	-
Hua institucioneve financiare (Shënimi 17)	1.87%	4,530,299	3,166,392	1,358,361	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve (Shënimi 18)	24.21%	10,803,216	2,257,951	2,548,684	2,925,227	2,884,825	186,529	-
Totali i aktiveve		**16,295,746**	**6,392,120**	**3,907,045**	**2,925,227**	**2,884,825**	**186,529**	**-**
Hua								
Hua me normë interesi fikse (Shënimi 23)	7.18%	7,349,893	851,980	770,365	1,851,984	3,875,563	-	-
Hua me normë interesi variabël (Shënimi 23)	6.52%	1,609,979	1,104,942	505,037	-	-	-	-
Borxh i varur (Shënimi 24)	8.51%	500,000	-	-	-	500,000	-	-
Total hua		**9,459,872**	**1,956,922**	**1,275,403**	**1,851,984**	**4,375,563**	**-**	**-**
Pozicioni Neto		**6,835,874**	**4,435,198**	**2,631,643**	**1,073,243**	**(1,490,738)**	**186,529**	

Balanca neto e huave dhënë institucioneve financiare është 343,039 mijë Lek (2023: -3,263 mijë Lek) . Balanca neto e huave është 8,906,975 mijë Lek (2023: 6,915,604 mijë Lek). Në pasqyrat financiare të vitit 2024 dhe 2023 aktivet dhe pasivet financiare janë netuar dhe paraqitur në bazë neto.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit (vazhdim)*

			31 Dhjetor 2023					
Aktive:	**Norma efektive e interesit**	**Totali**	**Deri ne 6 muaj**	**6 - 12 muaj**	**1 - 2 vjet**	**2 - 5 vjet**	**Me shumë se 5 vjet**	**Jo subjekti i rivlerësimit të interesit**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (Shënimi 16)	-	833,276	833,276	-	-	-	-	-
Hua institucioneve financiare (Shënimi 17)	1.30%	3,382,685	2,420,492	956,769	-	5,424	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve (Shënimi 18)	23.80%	8,859,172	1,848,172	2,127,377	2,429,427	2,339,801	114,395	-
Totali i aktiveve		**13,075,133**	**5,101,940**	**3,084,146**	**2,429,427**	**2,345,225**	**114,395**	**-**
Hua								
Hua me normë interesi fikse (Shënimi 23)	6.40%	5,404,115	749,314	705,918	2,278,432	1,670,451	-	-
Hua me normë interesi variabël (Shënimi 23)	6.11%	1,562,831	43,966	395,992	344,358	778,515	-	-
Obligacione (Shënimi 24)	8.80%	500,000	0	0	0	500,000	-	-
Total hua		**7,466,946**	**793,280**	**1,101,910**	**2,622,790**	**2,948,966**	**-**	**-**
Pozicioni Neto		**5,608,187**	**4,308,660**	**1,982,236**	**(193,363)**	**(603,741)**	**114,395**	

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Analiza e riçmimit të normës së interesit (vazhdim)

Administrimi i normave të interesit brenda limitit të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit duke përdorur skenarë të ndryshme standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenarët standarde të cilat konsiderohen një herë në muaj përfshijnë një rënie ose rritje paralele me bazë pikësh 100 (bp) në të gjitha kurbat e kthimit në të një rritje ose rënie prej 50 bp në të gjitha kurbave të kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit për një rritje ose ulje të normave të interesit të tregut për fondet e marra hua është si më poshtë:

	100 bp Rritje paralele	100 bp Rritje paralele	50 bp Rritje Paralele	50 bp Rritje Paralele
Më 31 Dhjetor 2024	68,359	(68,359)	34,179	(34,179)
Më 31 Dhjetor 2023	56,082	(56,082)	28,041	(28,041)

Analiza e ndjeshmërisë tregon ndikimin në fitim ose humbje të Grupit. Nuk ka ndikim në balancën e kapitalit, përveçse ndikimit direkt në fitim humbje.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Grupit, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç risqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit p.sh ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuara të sjelljes Grupit. Risqet operacionale lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Grupit dhe janë risqe që hasen nga të gjitha shoqëritë ne biznes.

Objektivi i Grupit është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Grupit me efektivitetin e përgjithshëm të kostove, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve që të adresohet rreziku operacional i caktohet drejtuesve të lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Grupit për administrimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtimi me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentimi i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të risqeve operacionale të identifikuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar risqet e identifikuar
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimit rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve emergjencës
- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet e etikës dhe biznesit
- zbutja e rrezikut, duke përfshirë sigurimin në rastet kur është efektiv

Pajtimi me standardet e Grupit mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i Brendshëm. Rezultatet e rishikimit të auditimit të brendshëm diskutohen me drejtimin e njësive të biznesit, duke përgatitur përmbledhje të cilat i paraqiten Komitetit të Auditimit dhe drejtimit të lartë të Grupit.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Administrimi i kapitalit

Kërkesa për kapital minimal

Në bazë të vendimit nr 1 datë 17 Janar 2013 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë kapitali minimal për institucionet financiare jo-banka të cilat ofrojnë shërbimin e kredidhënies është 100 milion Lek.

Kapitali rregullator

Grupi është subjekt i disa kërkesave rregullatore me të cilat ajo duhet të pajtohet. Në baze të nenit 11 të vendimit nr 2 datë 17 janar 2013 e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë institucionet Mikro-financiare duhet të plotësojnë në çdo kohë kërkesat e mëposhtme:

- Raporti i kapitalit ndaj totalit te aktivit nuk duhet të jetë më i vogël se 10%.
- Raporti i kapitalit ndaj mjeteve fikse të trupëzuara dhe jo-të trupëzuara neto nuk duhet të jetë më i vogël se 100%.
- Raporti i kapitalit ndaj totalit të huave me probleme nuk duhet të jete më i vogël se 100%.
- Raporti i kapitalit i paguar në natyrë ndaj kapitalit nuk duhet të kalojë 50%.

Ekspozimi i lejuar maksimal

Në bazë vendimit nr 2, neni nr 7.3 date 17 Janar 2013 të Këshillit te Mbikëqyrjes te Bankës së Shqipërisë ekspozimi ndaj një personi apo një grupi palësh të lidhura nuk duhet të jetë më shumë se 15% e kapitalit. Më 31 Dhjetor 2024 ekspozimi ndaj I.F.J.B. NOA sh.a Kosova është 11.0% e kapitalit (2023: 11.2%).

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 kërkesat e mësipërme janë plotësuar duke përfshirë normën e raportit të kapitalit ndaj totalit të aktiveve që është 18.5% dhe 17.3% respektivisht. Politika e Grupit është për ruajtjen e një baze kapitali brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha të ardhurat nga aktiviteti për të mbështetur zhvillimin në të ardhmen. Grupi njeh nevojën për të patur një balancë ndërmjet të ardhurave të larta që janë të mundshme nëpërmjet kredimarrjes së lartë dhe avantazheve dhe sigurisë që lejon një pozicion të shëndoshë të kapitalit. Nuk ka patur ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kapitalit të Grupit gjatë periudhës.

Informacion shtesë mbi fluksin e parasë

Ndryshime në detyrime që rrjedhin nga aktivitetet e financimit:

	2024	2023
Gjendja në fillim	**7,020,175**	**5,605,951**
Pjesë të flukseve të parasë:		
Marrjet	5,267,187	3,562,807
Ripagesat	(2,836,405)	(1,704,921)
Jo pjesë të flukseve të parasë:		
Interes i përllogaritur	62,572	21,006
Ndikimi i kursit të këmbimit	(413,688)	(464,668)
Gjendja në fund	**9,099,841**	**7,020,175**

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Grupi kryen vlerësime dhe gjykime të cilat ndikojnë vlerat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, dhe që rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë mbi ngjarjet e ardhshme të cilat vlerësohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

(i) Tatim fitimi

Drejtimi beson se llogaritja e tatimit mbi fitimin është e përshtatshme pavarësisht pasigurive që ekzistojnë në mjedisin tatimor shqiptar dhe në legjislacionin në fuqi dhe se vizitat e ardhshme fiskale nuk do të sjellin efekte të rëndësishme në pasqyrat e pozicionit financiar, rezultatin nga aktiviteti apo në flukset monetare.

(ii) Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve

Siç përshkruhet në Shënimin 17, Grupi kompenson overdraftet e marra nga bankat lokale, kundrejt depozitave të vendosura në të njëjtat banka si kolateral, në përputhje me politikën kontabël 5 (iv). Në bërjen e këtij kompensimi, Drejtimi ka përcaktuar që kërkesat e SNK 32 janë përmbushur, përkatësisht:

- Grupi ka të drejtë ligjore të kompensojë kolateralin e saj në formën e mjeteve monetare me balancën e papaguar të overdraftit në çdo kohë, gjatë rrjedhës normale të biznesit, dhe si ne rastin e mos pagesës ose te likuidimit nga pala tjetër.
- Grupi ka për qëllim të shlyejë aktivin dhe detyrimin në bazë neto.

Bazuar në të drejtën ligjore, Drejtimi ka kryer një analizë të plotë, duke marrë këshillimin e duhur ligjor për të konfirmuar se ekziston e drejta e kompensimit, me ane te kontratës si dhe në përputhje me legjislacionin vendor. Duke pasur parasysh natyrën e rregulluar të industrisë së palës tjetër, gjykimi ligjor kërkohet të analizojë të drejtën e kompensimit në situatën e likuidimit të Bankave.

Qëllimet e Grupit në lidhje me shlyerjen e tepricave të overdrafteve te garantuara me depozita kolaterali ne formën e mjeteve monetare, janë qe të shlyhen në bazë neto, në rrjedhën normale të biznesit. Grupi ka një histori të kufizuar të shlyerjes së këtyre marrëveshjeve gjate viteve te fundit, volumi i overdrafteve dhe depozitave te kolateralit ne formën e mjeteve monetare është rritur, dhe kontratat janë mbyllur me një numër të kufizuar të çështjeve të netuara. Në vlerësimin e Drejtimit, Grupi do t'i mbyll këto marrëveshje në baza neto dhe do të ketë aftësinë ta bëjë këtë.

(iii) Fonde për humbjet nga huatë dhe paradhëniet

Matja e humbjeve nga provigjonimi, sipas SNRF19 gjatë gjithë kategorive të aktiveve financiare ne vetvete kërkon gjykim, veçanërisht, vlerësimi i shumës dhe koha e flukseve të ardhshme monetare dhe vlera e kolateralit gjatë përcaktimit të humbjes nga provigjonimi dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë. Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshimet në të cilën mund të sjellin nivele të ndryshme provigjonimi.
Kalkulimi i ECL-ve të Grupit janë rezultate të një modeli kompleks me një numër supozimesh themelore rreth zgjedhjes se inputeve variabël dhe ndërvarësisë së tyre.
Elementë të modelit të ECL-ve të cilat janë konsideruar si gjykime kontabël dhe vlerësime përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Grupit, i cili cakton (ditëve në vonesë) PD-të notat individuale.
- Kriteret e Grupit për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë dhe kështu që provojuni për aktivet financiare duhet të maten në bazë të ECL përgjatë jetës LTECLdhe vlerësimi cilësor.
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL e tyre janë vlerësuar në baza kolektive.
- Zhvillimi i modelit të ECL-ve përfshin disa formula zgjedhjet e inputeve.

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(iii) Fonde për humbjet nga huatë dhe paradhëniet (vazhdim)

- Përcaktimi i qasjeve midis skenarëve makroekonomik dhe inputeve ekonomike të tilla si nivele të papunësisë, vlera e kolateralit, dhe efektet ne PD, EAD, LGD
- Zgjedhja e skenarëve të ardhshme makroekonomike dhe pesha e probabilitetit të tyre për të nxjerrë inpute ekonomike në modelet ECL.

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 nga analiza dhe observimet e faktorëve makro-ekonomikë modeli paraqet një autokorrelacion negativ. Ne këtë kuptim faktori makro-ekonomik nuk është marrë në konsideratë gjatë përllogaritjeve, vetëm skenari bazë është marrë në konsideratë.
Skenarët janë përcaktuar në politikën e provigjonimit por ka qenë në politikën e Grupit për të rishikuar në mënyrë të rregullt modelet në kontekst të eksperiencës mbi humbjet aktuale dhe bërjen e rregullimeve kur është e nevojshme.

Vlerësime kontabël të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël të Grupit

Vlerësime kontabël të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël të Grupit përfshijnë:

Vlerësimin e instrumenteve financiare

Politikat kontabël të Grupit në matjen e vlerës së drejtë janë paraqitur në shënimin 4g, (vi).

Vlera e drejtë e aktivit dhe detyrimit financiar është paraqitur vetëm për qëllime deklarimi në pasqyrat financiare. Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuara ose kuotime të çmimit nga tregtarët. Për të gjitha Instrumentet e tjerë financiare Grupi përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg që veprojnë me kushtet e tregut. Gjykimi dhe vlerësimi i Menaxhimit kërkohet zakonisht për përzgjedhjen e metodës së duhur të modelit, përcaktimin e flukseve të pritshme monetare në instrumentet financiare të vlerësuara, përcaktimin e probabilitetit të palëve, parapagimeve dhe zgjedhjes së normave të skontimit të duhura.

Vlera e drejtë e një aktivi financiar është çmimi i shitjes së aktivit të shitur ose shuma e paguar për transferimin e detyrimit në një transaksion normal në tregun kryesor (me më shumë avantazh) në datën e matjes kundrejt kushteve të tregut aktual (p.sh. çmim shitjeje) pavarësisht nëse ai çmim është i matshëm direkt apo i vlerësuar duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi. Grupi nuk bën përllogaritje për vlerën e drejtë për aktive financiare (kredi dhe paradhënie klientësh) dhe detyrime financiare (hua) për shkak të mungesës të dhënave të mbikëqyrura dhe të pakontrollueshme të tregut.

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to dhe kredive ndaj institucioneve financiare për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër është shuma e arkëtueshme në datën e raportimit. Pjesa më e madhe e portofolit të huave dhe paradhënieve për klientët bazohet në normat fikse të interesit. Drejtimi e konsideron si jo praktike të kryejë një llogaritjen e vlerës së drejtë të huave dhe paradhënieve për klientët pasi nuk ka transaksione të tregut të mbikëqyrura për kredi homogjene dhe beson se vlerat e drejta përafrojnë vlerën kontabël.
Për më tepër, bazuar në analizën, maturiteti mesatar i kredive është 25 muaj ndërsa pjesa e kredive me maturitet 5 vjet është e vogël, prandaj pritet që vlera e drejtë për përafrojë vlerën kontabël. Për kreditë me normë interesi fikse dhe afat maturimi të shkurtër nuk do të ketë ndikim material midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë për qëllime dhënie informacioni. Humbjet e pritshme të ardhme nuk merren parasysh. Të gjitha aktivet e Grupit janë kategorizuar si niveli 3 për qëllime të matjes së vlerës së drejtë.

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(iii) Fonde për humbjet nga huatë dhe paradhëniet (vazhdim)

Vlerësime kontabël të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël të Grupit (vazhdim)

Përcaktimi i afateve të qirasë për kontratat e qirasë me rinovim dhe opsion mbylljeje (Grupi si qiradhënës)

Grupi përcakton afatet e qirasë si afate jo të anulueshme të qirasë, bashkë me çfarëdo periudhe të siguruar me një opsion për të zgjatur qiranë nëse është me siguri të ushtrohet, ose ndonjë periudhë e mbuluar nga një opsion për të ndërprerë qiranë nëse është e sigurt që nuk do të ushtrohet.
Grupi ka disa kontrata qiraje të cilat përshijnë opsionin e zgjatjes ose të mbylljes. Grupi zbaton gjykimin për të vlerësuar nëse është një siguri e arsyeshme për të ushtruar ose jo opsionin e rinovimit ose të mbylljes së qirasë. Kjo do të thotë, konsideron të gjithë faktorët e rëndësishëm që krijojnë një nxitje ekonomike për të ushtruar ose rinovimin ose mbylljen. Pas datës së fillimit Grupi vlerëson afatet e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme apo ndryshim në rrethana të kontrollueshme të cilat ndikojnë në aftësinë për të ushtruar apo jo opsionin e rinovimit apo të mbylljes (p.sh. përmirësimet e rëndësishme në ndërtim të qirave ose përshtatjen e aktivit me qira).

Vlerësimi i normës rritëse të huasë: Grupi nuk mund të përcaktojë me lehtësi normën efektive të interesit në qira, për më tepër për të matur detyrimet e qirasë është përdorur norma rritëse e huasë ("IBR"). IBR është norma e interesit që Grupi duhet të paguajë për të marrë hua në kushte të njëjta, fondin e duhur për të siguruar një aktiv me vlerë të njëjtë me një aktiv me të drejtë përdorimi në një ambient ekonomik të ngjashëm. Norma e përdorur nga Grupi është 6.14% në LEK (2023: 7.28%) dhe 6.77% EUR (2023: 5.8%), i cili përfaqëson normën e interesit të huave 3 vjeçar ndaj huadhënësve dhe bankave. Për më tepër IBR reflekton çfarë Grupi "duhet të paguajë", e cila kërkon vlerësim kur normat e fshehura janë të mundshme, ose kur ato kanë nevojë të rregullohen për të reflektuar afatet dhe kushtet e qirasë. Grupi vlerëson IBR duke përdorur imputet e dukshme (te tilla si normat e interesit të tregut) kur janë të mundshme dhe është e detyrueshme për të bërë një rregullim specifik individual për të paraqitur afatet dhe kushtet e qirasë (të tilla si afatet dhe kushtet e qirasë).

(iv) Qiratë

Caktimi I normës së përshtatshme të skontimit për të matur detyrimet e qirase sic shënohet më poshtë, Grupi hyn në marrëveshje qiraje me pronarët e palëve të treta dhe si rrjedhim norma efektive e interesit në qiranë përkatëse nuk përcaktohet lehtë. Prandaj Grupi përdor normën e saj rritëse të huamarjes për përcaktimin e detyrimeve të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Norma rritese e huamarrjes është norma e interesit që Grupi duhet ti paguajë huadhënësit ne të njëjtat kushte, gjë që kërkon vlerësim kur nuk ka norma të përcaktuara saktë.

Grupi konsultohet me bankieret e saj kryesore për të përcaktuar cfarë norme interesi pritet nëse Grupi merr hua shuma parash për të blerë një aktiv të njëjtë me atë i cili është marrë me qira. Këto norma rregullohen aty kur është e nevojshmë për të pasqyruar vlefshmërine e huasë së njësisë ekonomike në një marëveshje qiraje dhe gjëndjen specifike të aktivit të dhenë me qira.

(v) Efekti i pasigurisë në vlerësim:

Efekti I ndryshimit në normën rritëse të huamarrjes për qiratë gjatë periudhës së raportimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlerësimi	Ndryshimet në vlerësim	Efekti në aktive me të drejtë përdorimi	Efekti në detyrimin e qirasë
Rritja e normës së huasë	1% rritje të normës së huasë	Zvogëlim me 1,814 mijë LEK	Zvogëlim me 1,476 mijë LEK

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(v) Vlerësimi i Drejtimit për Vijimësinë

Gjatë vitit 2024 Grupi parashikoi një rritje të portofolit prej 25% dhe arriti një rritje prej 22%. Grupi ka qenë në përputhje me të gjithë raportin rregullator gjatë vitit 2024 (Shënimi 6 (e)), Grupi nuk pret ndonjë shkelje të raporteve rregullatore.

Më 31 dhjetor 2024, kapitali i Grupit është 2,613,841 mijë lekë (2023: 2,329,606 mijë lekë), dhe fitimi neto për vitin 2024 është 497,520 mijë lekë (2023: 401,502 mijë lekë). Performanca financiare e Grupit u përmirësua në vitin 2024, fitimi para tatimit u rrit me 22% krahasuar me vitin 2023, rezultati financiar u ndikua pozitivisht nga të ardhurat neto nga interesi të cilat u rritën me 31%, dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet u rritën me 33%. Për vitin 2025 Grupi pret të rrisë portofolin bruto të kredisë me 20%.

Drejtimi i Grupit ka bërë një vlerësim të aftësisë së Grupit për të vazhduar si vijimësi duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur më sipër dhe është i kënaqur që Grupi ka burimet për të vazhduar biznesin për të ardhmen. Për më tepër, Drejtimi i Grupit nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqerise për të vazhduar si vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare te konsoliduara vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e konceptit te vijimësisë.

8. Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat te përllogaritura me metodën efektive te interesit për vitin 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Hua dhe paradhënie klientëve	2,443,547	1,825,922
Hua institucioneve të tjera financiare	61,591	31,866
Total	**2,505,138**	**1,857,788**

9. Shpenzime për interesa

Shpenzime te interesit të përllogaritura me metodën efektive te interesit për vitin 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Interesa nga huatë	(751,671)	(513,585)
Interesa nga detyrimet e qirasë	(13,090)	(11,055)
Total	**(764,761)**	**(524,640)**

10. Tarifa dhe komisione, neto

Tarifat dhe komisionet neto për vitin 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve një moment te caktuar:		
Të ardhura si agjent sigurimi	160,196	113,140
Tarifa të tjera të marra	36,515	23,628
Të ardhura totale të marra nga klientët	**196,711**	**136,768**
Shpenzime për tarifa dhe komisione:		
Komisione Bankare	(2,908)	(3,088)
Total tarifa dhe komisione bankare	**(2,908)**	**(3,088)**
Tarifa dhe komisione, neto	**193,803**	**133,680**

Të gjitha të ardhurat të marra nga klientët janë të gjeneruara në Shqipëri.

11. Humbja nga provizioni i huave dhe paradhënie vetë klientëve

11.1 Humbja nga provizioni i huave dhe për paradhënieve të klientëve për fundin e vitit 2024 dhe 2023:

	2024	2023
Më 1 janar	**(633,960)**	**(549,702)**
Shpenzimi i vitit	(440,010)	(271,057)
Aktive të çrrgjistruara	-	78,278
Fshirjet	105,165	107,403
Efekti i kursit të këmbimit	1,698	1,118
Në fund të periudhës	**(967,107)**	**(633,960)**

11.2 Fitimi neto nga fshirjet e kredive dhe paradhëniet e klientëve

Fitimi neto nga fshirjet i kredive dhe paradhënieve për klientët, paraqet rikuperimet nga huatë e fshira te netuar me kostot direkte të mbledhjes. Rikuperimet kryhen nga ekipi i brendshëm dhe nga ofruesit e shërbimeve të jashtëm. Rikuperimet përfshijnë dhe zërat jo cash të cilat përfaqësojnë ekzekutimin e kolateraleve, shuma e ekzekutuar gjatë vitit 2024 paraqitet në shënimin 21 në zërin Inventar dhe aktive të tjera.

	2024	2023
Fitimi neto nga fshirjet i kredive dhe paradhënieve për klientët	95,183	94,511
Total	**95,183**	**94,511**

12. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitet 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Te ardhura nga grantet	1,225	1,101
Të tjera	19,313	16,924
Total	**20,538**	**18,025**

Të tjera, përfshijnë kryesisht komisionet për pagesat në cash, RBS dhe rimbursime të tjera të kredive në vonesë nga skema e garancisë së Programit të BE-së për Punësimin dhe Inovacionin Social (EaSI) në shumën 181 mijë LEK (2023: 2,217 mije LEK).

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitet 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Paga Bruto	473,792	386,571
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	70,356	59,069
Bonuse	102,740	57,510
Fond pensioni vullnetar me kontribut te përcaktuar	4,877	2,345
Benefite te tjera	45	-
Bonuse te perllogaritura/(rrimarje)	(22,374)	-
Total	**629,435**	**505,495**

14. Shpenzime operative të tjera

Shpenzime të tjera për vitet 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	2024	2023
Marketing	59,266	55,692
Konsulencë, tarifa ligjore dhe shërbime të tjera	33,165	33,484
Shpenzime për burime njerëzore dhe trajnime	19,646	27,939
Shpenzime per mirembajtje te sistemeve informatike	35,575	22,556
Energji, ujë etj.	22,576	19,157
Shpenzime transporti	18,742	17,659
Shpenzime komunikimi	18,908	14,967
Shpenzime të menaxhimit dhe të bordit drejtues	17,201	14,839
Shpenzime sigurimi	7,770	6,812
Shpenzime zyre	6,401	6,740
Të tjera	31,287	19,586
Total	**270,536**	**239,431**

Shpenzimet e tjera përfshijnë kryesisht: taksa bashkie 4,638 mijë Lek (2023: 3,916 mijë Lek); dieta 4,512 mije Lek (2023: 4,702 mije Lek), shërbim sigurie 6,824 mije Lek (2023: 4,325 mije Lek), shpenzime takime biznesi 2,085 mije Lek (2023: 3,662 mije Lek).

15. Tatimi mbi fitimin

	2024	2023
Shpenzim tatim fitimi aktual	95,715	81,655
(Të ardhura)/shpenzime tatimore të shtyra	(6,108)	(3,151)
Total shpenzim tatim fitimi	**89,607**	**78,504**

15. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Në vijim është rakordimi i normës efektive të tatimit:

	Norma efektive e tatimit	31-Dec-24	Norma efektive e tatimit	31-Dec-23
Fitimi para tatimit		**587,127**		**480,006**
Tatimi duke përdorur normën e tatimit lokal të kompanisë	15%	88,069	15.00%	72,001
Efekti i shkallës së tatimit në juridiksionet e huaja	(2.34%)	(13,752)	(2.74%)	(13,139)
Efekti i tatimit nga:				
Shpenzime te panjohura	0.79%	4,652	0.79%	3,812
Te ardhura te perjashtuara nga tatami	0.80%	4,712	0.74%	3,535
Humbjet e vitit aktual për të cilat nuk u njohën asetet tatimore të shtyra	2.05%	12,034	3.22%	15,446
Shpenzim tatim fitimi	**16.3%**	**95,715**	**16.33%**	**81,655**

Aktivi tatimor i shtyrë më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 është si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktiv tatimor i shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	8,117	6,755
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	2,083	1,640
Rezerva e humbjes nga kreditë (përdorimi për herë të parë SNRF9)	-	132
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	24,731	20,161
Aktiv tatimor i shtyre SNRF 16	27,014	25,640
Detyrim tatimor i shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	(89)	(78)
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	-	-
Detyrim tatimor I shtyre SNRF 16	(27,952)	(26,454)
Aktiv tatimor i shtyrë, neto	**33,904**	**27,796**

15. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi i shtyrë për fundin e vitit 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet në tabelën më poshtë si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Ndryshimi në aktivin tatimor të shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	1,361	1,039
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	443	235
Rezerva e humbjes nga kreditë(përdorimi për herë të parë SNRF9)	(132)	-
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	4,570	2,945
SNRF 16	1,501	7,519
Ndryshimi në detyrimin tatimor të shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	(16)	(81)
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	-	-
SNRF 16	(1,619)	(8,506)
Ndryshimi neto	**6,108**	**3,151**

Aktivet tatimore të shtyra nuk janë njohur në lidhje me humbjen nga I.F.J.B NOA sh.a Kosovë, nuk ka probabilitet që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të jetë i disponueshëm kundrejt grupit që mund të përdorë përfitimet prej tyre.

	31 December 2024		31 December 2023	
	Shuma bruto	Efekti tatimor	Shuma bruto	Efekti tatimor
Humbja tatimore	12,034	1,203	15,446	1,544

		2024 Mbaron afati		2023 Mbaron afati
Humbja tatimore që i mbaron afati	1,203	2025-2029	1,544	2024-2028

16. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Mjete monetare në arkë	3,993	8,252
Llogari rrjedhëse	570,831	825,024
Depozita afatshkurtra	392,951	-
Total	**967,776**	**833,276**

Nuk ekziston një klasifikim për bankat që operojnë në Shqipëri. Bazuar në vlerësimin individual të kryer, nuk vlerësohen humbjet te pritshme për parate në banka.

16. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to (vazhdim)

Llogarite rrjedhëse ne banke janë te detajuara si ne vijim:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Credins Bank	787,233	182,309
Banka Kombetare Tregetare	65,899	535,509
Union Bank	13,387	10,188
Raiffeisen Bank	68,598	45,765
Tirana Bank	11,481	11,912
First Investment Bank	3,074	25,385
OTP Bank	800	7,022
ProCredit Bank	5,090	5,353
ABI Bank	8,221	-
Pribank	3,228	1,581
Banka Pro Biznes	2,341	-
TEB	78	-
Procredit Bank	316	-
Total	**963,783**	**825,024**

17. Hua Institucioneve Financiare

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua institucioneve financiare	343,039	(3,263)
Minus provizionet	-	-
Total	**343,039**	**(3,263)**

Siç është paraqitur në Shënimin 5, Hua Institucioneve Financiare më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 janë paraqitur neto nga gjendja e overdrafteve me vlerë respektivisht prej 4,181,715 mijë Lek (2023: 3,385,948 mijë Lek). Maturiteti mesatar dhe norma mesatare e interesit për huatë në Euro dhe Lek është respektivisht 12 muaj me normën 1.63% (2023: 1.3%). Nuk ekziston një klasifikim për bankat që operojnë në Shqipëri. Bazuar në vlerësimin individual të kryer, nuk vlerësohen humbjet te pritshme për "Hua institucioneve financiare".

Hua institucioneve financiare rezultojnë te detajuara si ne vijim:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Banka Kombetare Tregetare	133,254	20,702
Credins bank	105,097	(13,289)
Tirana Bank	21,673	(21,327)
First Investment Bank	26,054	17,298
OTP Bank	21,613	(21,741)
ProCredit Bank	7,429	-
Union Bank	27,919	15,093
Total	**343,039**	**(3,263)**

17. Hua Institucioneve Financiare (vazhdim)

31 Dhjetor 2024	Balanca e ovedrafteve te garantuara me kolateral ne para	Depozitë me afat në lekë e lënë peng si kolateral	Balanca e depozitave me afat ne leke, neto
Banka Kombetare Tregetare	833,053	966,307	133,254
Credins bank	843,482	948,578	105,097
Tirana Bank	1,098,732	1,120,405	21,673
First Investment Bank	324,412	350,466	26,054
OTP Bank	523,920	545,533	21,613
ProCredit Bank	290,211	297,641	7,429
Union Bank	267,906	295,824	27,919
Total	**4,181,715**	**4,524,753**	**343,039**

31 Dhjetor 2023	Balanca e ovedrafteve te garantuara me kolateral ne para	Depozitë me afat në lekë e lënë peng si kolateral	Balanca e depozitave me afat ne leke, neto
Tirana Bank	931,062	909,736	(21,326)
Banka Kombetare Tregetare	699,033	719,735	20,702
Credins Bank	611,021	597,732	(13,289)
OTP Bank	598,515	576,774	(21,741)
First Investment Bank	353,627	370,925	17,298
Union Bank	192,690	207,783	15,093
Total	**3,385,948**	**3,382,685**	**(3,263)**

Balanca neto e detyrimit të overdrafteve me OTP bank dhe Tirana Bank është negative më 31 dhjetor 2023 për shkak të zhvlerësimit të monedhës EUR, monedhë ne te cilen janë vendosur depozitat pranë institucioneve financiare.

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto

Huatë dhe paradhëniet e klientëve më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua dhe paradhënie klientëve, bruto	11,716,964	9,464,042
Interesi i përllogaritur dhe të tjera të ngjashme	181,682	143,996
Komisione te tjera	2,380	6,009
Ripagesa të parakohshme	(130,703)	(120,915)
Rezerva e provizionit	(967,107)	(633,960)
Total	**10,803,216**	**8,859,172**

	31 Dhjetor 2024			31 Dhjetor 2023		
	Vlera bruto	ECL	Vlera neto	Vlera bruto	ECL	Vlera neto
Individë	3,016,842	526,522	2,490,320	2,585,652	340,876	2,244,776
Biznes	8,881,807	440,585	8,441,223	7,022,385	293,084	6,729,301
Total	**11,898,649**	**967,107**	**10,931,542**	**9,608,037**	**633,960**	**8,974,077**

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto (vazhdim)

Kredi për Individë

	2024				2023			
	Stage 1	**Stage 2**	**Stage 3**	**Total**	**Stage 1**	**Stage 2**	**Stage 3**	**Total**
Vlera bruto më 1 Janar	**2,143,250**	**69,389**	**315,716**	**2,528,354**	**1,376,629**	**45,837**	**260,213**	**1,682,679**
Kredi të reja të disbursuara ose të blera	2,479,722	0	0	2,479,722	2,287,966	341	-	**2,288,307**
Kredi të fshira ose të shlyera	(1,901,504)	(24,523)	(28,642)	(1,954,668)	(1,279,040)	(18,007)	(113,852)	**(1,410,899)**
Transferuar në Klasën 1	4,001	(4,001)	-	-	(79,471)	31,038	48,433	-
Transferuar në Klasën 2	(263,505)	264,103	(598)	-	(152,171)	152,171	-	-
Transferuar në Klasën 3	-	(213,531)	213,531	-	-	(141,753)	141,753	-
Riklasifikim	-	4,910	-	4,910	-	-	-	-
Kredi te fshira	-	-	(25,551)	(25,551)	-	-	(20,634)	**(20,634)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(14,923)	(366)	(635)	(15,925)	(10,663)	(238)	(198)	**(11,099)**
Vlera bruto më 31 Dhjetor	**2,447,041**	**95,980**	**473,821**	**3,016,842**	**2,143,250**	**69,389**	**315,715**	**2,528,354**

	2024				2023			
	Stage 1	**Stage 2**	**Stage 3**	**Total**	**Stage 1**	**Stage 2**	**Stage 3**	**Total**
Rezerva ECL më 1 Janar	**18,818**	**7,834**	**313,899**	**340,550**	**23,063**	**8,946**	**260,213**	**292,222**
Kredi te disbursuara ose të blera	83,145	-	-	83,145	63,524	-	-	**63,524**
Kredit të fshira ose të shlyera	(6,414)	(939)	(22,966)	(30,319)	(12,390)	(1,023)	(95,421)	**(108,834)**
Transferuar në Klasën 1	56	(56)	-	-	(1,092)	357	735	-
Transferuar në Klasën 2	(156,710)	156,803	(93)	-	(7,189)	7,189	-	-
Transferuar në Klasën 3	-	(153,635)	153,635	-	(99,422)	(8,367)	107,789	-
Rimatja e ECL, neto	96,248	7,978	55,119	159,345	53,494	6,582	54,322	**114,398**
Kredi te fshira	-	-	(25,551)	(25,551)	(1,095)	(5,833)	(13,706)	**(20,634)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(102)	(19)	(526)	(647)	(76)	(17)	(33)	**(126)**
Rezerva ECL më 31 Dhjetor	**35,041**	**17,966**	**473,516**	**526,523**	**18,817**	**7,834**	**313,899**	**340,550**

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto (vazhdim)

Kredi për Biznes

	2024				2023			
	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total
Vlera bruto më 1 Janar	**6,568,426**	**302,808**	**208,449**	**7,079,683**	**5,500,028**	**143,978**	**200,034**	**5,844,040**
Kredi të reja të disbursuara ose të blera	6,099,140	0	0	**6,099,140**	4,910,041	-	-	**4,910,041**
Kredi të fshira ose të shlyera	(4,063,571)	(63,332)	(20,794)	**(4,147,697)**	(3,411,192)	(33,532)	(45,041)	**(3,489,765)**
Transferuar në Klasën 1	11,837	(11,837)	-	-	(18,881)	7,337	11,544	-
Transferuar në Klasën 2	(412,368)	414,109	(1,741)	-	(317,109)	343,711	(26,602)	-
Transferuar në Klasën 3	-	(254,074)	254,074	-	-	(155,848)	155,848	-
Riklasifikim	-	1,116	-	**1,116**	-	-	-	-
Kredit te fshira	-	-	(79,614)	**(79,614)**	-	-	(86,769)	**(86,769)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(68,989)	(1,519)	(313)	**(70,821)**	(94,461)	(2,838)	(565)	**(97,864)**
Vlera bruto më 31 Dhjetor	**8,134,475**	**387,271**	**360,061**	**8,881,807**	**6,568,426**	**302,808**	**208,449**	**7,079,683**

	2024				2023			
	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total
Rezerva ECL më 1 Janar	**31,821**	**60,956**	**200,633**	**293,410**	**46,561**	**16,806**	**194,114**	**257,481**
Kredi te disbursuara ose të blera	41,441	-	-	**41,441**	36,967	-	-	**36,967**
Kredit të fshira ose të shlyera	(17,018)	334	(10,801)	**(27,485)**	(9,314)	(2,410)	(28,161)	**(39,885)**
Transferuar në Klasën 1	39	(39)	-	-	50	(50)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(144,688)	144,702	(14)	-	(50,597)	55,562	(4,965)	-
Transferuar në Klasën 3	-	(137,772)	137,772	-	(59,964)	(12,052)	72,016	-
Rimatja e ECL, neto	111608	8,408	93,866	**213,882**	68757	8,053	49,831	**126,641**
Kredi te fshira	-	-	(79,614)	**(79,614)**	-470	(4,662)	(81,637)	**(86,769)**
Rregullim për kursin e këmbimit	(576)	(429)	(47)	**(1,052)**	(169)	(291)	(565)	**(1,025)**
Rezerva ECL më 31 Dhjetor	**22,628**	**76,159**	**341,796**	**440,584**	**31,821**	**60,956**	**200,633**	**293,410**

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe Aktiv me të drejtë përdorimi

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

					Aktiv me të drejtë përdorimi		
	Pajisje elektronike	**Automjete**	**Pajisje dhe mobilje**	**Përmirsime të ambienteve me qera**	**Ndërtesa**	**Automjete**	**Total**
Kosto							
Më 1 Janar 2023	**187,019**	**46,508**	**54,072**	**32,898**	**263,387**	**31,991**	**615,875**
Shtesa	21,502	17,963	14,894	19,329	120,648	9,388	203,724
Pakësime	(3)	(3,325)	(5,110)	-	-	-	(8,438)
Diferencë këmbimi	(514)	(175)	(140)	(91)	(1,351)	-	(2,272)
Më 31 Dhjetor 2023	**208,004**	**60,971**	**63,716**	**52,135**	**382,684**	**41,379**	**808,889**
Shtesa	12,406	10,349	11,658	9,400	54,791	25,388	123,992
Pakësime	(2,367)	(4,466)	(1,889)	-	-	-	(8,723)
Diferencë këmbimi	(614)	(206)	(167)	(107)	(1,590)	-	(2,685)
Më 31 Dhjetor 2024	**217,428**	**66,647**	**73,318**	**61,428**	**435,884**	**66,767**	**921,473**
Zhvlerësimi i akumuluar							
Më 1 Janar 2023	**(154,430)**	**(34,105)**	**(40,783)**	**(27,580)**	**(155,945)**	**(19,015)**	**(431,858)**
Zhvlerësim i vitit	(16,695)	(6,792)	(7,270)	(3,939)	(57,445)	(7,334)	(99,475)
Pakësime	3	3,325	5,110	-	-	-	8,438
Diferencë këmbimi	83	28	32	7	204	-	354
Më 31 Dhjetor 2023	**(171,039)**	**(37,544)**	**(42,911)**	**(31,512)**	**(213,186)**	**(26,349)**	**(522,541)**
Zhvlerësim i vitit	(17,397)	(10,219)	(6,927)	(8,186)	(62,074)	(9,176)	(113,979)
Pakësime	2,367	4,466	1,889	-	-	-	8,723
Riklasifikim	(166)	432	351	(154)	-	-	462
Diferencë këmbimi	172	45	43	25	380	-	665
Më 31 Dhjetor 2024	**(186,062)**	**(42,820)**	**(47,555)**	**(39,828)**	**(274,880)**	**(35,525)**	**(626,669)**
Vlera kontabël neto							
Më 1 Janar 2023	**32,589**	**12,403**	**13,289**	**5,318**	**107,443**	**12,976**	**184,017**
Më 31 Dhjetor 2023	**36,965**	**23,427**	**20,805**	**20,623**	**169,498**	**15,030**	**286,348**
Më 31 Dhjetor 2024	**31,366**	**23,828**	**25,763**	**21,600**	**161,005**	**31,242**	**294,803**

Nuk ka asnjë aktiv te qendrueshem te trupezuar të vendosur si kolateral deri më 31 Dhjetor 2024

20. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Programe kompjuterike dhe licenca	Total
Kosto		
Më 1 Janar 2023	**217,349**	**217,349**
Shtesa	9,016	**9,016**
Pakësime	-	-
Diferencë këmbimi	(242)	**(242)**
Më 31 Dhjetor 2023	**226,123**	**226,123**
Shtesa	27,764	**27,764**
Pakësime	(612)	**(612)**
Diferencë këmbimi	(746)	**(746)**
Më 31 Dhjetor 2024	**252,529**	**252,529**
Amortizim i akumuluar		
Më 1 Janar 2023	**(199,020)**	**(199,020)**
Amortizimi i vitit	(9,337)	**(9,337)**
Pakësime	-	-
Diferencë këmbimi	20	**20**
Më 31 Dhjetor 2023	**(208,337)**	**(208,337)**
Amortizimi i vitit	(13,275)	**(13,275)**
Pakësime	612	**612**
Riklasifikim	(462)	**(462)**
Diferencë këmbimi	116	**116**
Më 31 Dhjetor 2024	**(221,346)**	**(221,346)**
Më 1 Janar 2023	**18,329**	**18,329**
Më 31 Dhjetor 2023	**17,786**	**17,786**
Më 31 Dhjetor 2024	**31,183**	**31,183**

21. Aktive të tjera

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 aktivet e tjera janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Inventari i kolateraleve të marra	64,248	64,313
Te arkëtueshme nga palët e treta	28,714	46,806
Parapagime për shërbime IT	26,542	31,828
Sigurim Stafi	5,088	4,341
Garanci Performace- Sigal Life Uniqa Group Austria	3,500	3,500
Të tjera	7,700	4,994
Total	**135,792**	**155,782**

Parapagimi për shërbimet e IT përfshin shumën e parapagimit 10,839 mijë LEK (2023: 8,311 mijë LEK) për Greenberg Consulting s.r.o për përmirësimin e sistemit front end. Përmirësimi pritet të finalizohet gjatë vitit 2025.

Garanci Performance- Sigal Life Uniqa Group Austria është garanci bankare e krijuar ne vitin 2021, bazuar në nenin 10.3 të rregullores nr 79 i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, miratuar me vendim Bordi nr 79, datë 31.08.2015. Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës.

21. Aktive të tjera (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2024 inventari i kolateraleve të marra prej 64,248 mijë Lek (31 Dhjetor 2023: 64,313 mijë Lek) i cili përfaqëson aktive marrë ne pronësi nga ekzekutimi i kolateralit të kredive me probleme. Vlerat e mësipërme paraqesin vlerë më të vogël më 31 Dhjetor dhe vlerën neto të realizueshme zvogëluar me koston e shitjes.

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2023
Vlera bruto, Balanca hapëse	**69,136**	**61,799**
Shtesa	10,727	7,601
Pakësime	(10,791)	(264)
Vlera bruto, total	**69,071**	**69,136**
Fondi I zhvlerësimit, balanca hapëse	(4,823)	(4,823)
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Fondi i zhvlerësimit, balanca mbyllëse	**(4,823)**	**(4,823)**
Vlera neto e aktiveve të rimarra	**64,248**	**64,313**

22. Grante

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023, grantet përbëhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Palladium International LLC	22,528	12,762
Total	**22,528**	**12,762**

Më 1 Nëntor 2022, NOA sh.a nënshkroi një marrëveshje me Palladium International LLC –për financimin ne sektorin e këpucëve dhe veshjeve për të kapërcyer kufizimet e sektorit.

23. Hua

Huatë, interesat sipas monedhës më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 janë paraqitur si më poshtë vijon:

	Normë mesatare e ponderuar e interesit	31 Dhjetor 2024	Normë mesatare e ponderuar e interesit	31 Dhjetor 2023
Normë fikse interesi				
EUR	5.94%	6,345,431	5.22%	5,075,163
LEK	6.26%	1,002,071	6.85%	538,592
Normë variabël interesi				
EUR	6.99%	823,483	6.20%	103,886
LEK	5.45%	788,887	5.88%	1,233,960
Interes i përllogaritur mbi huatë		139,969		68,574
Total		**9,099,841**		**7,020,175**
Afatshkurtër		3,444,982		2,778,056
Afatgjatë		5,514,889		4,173,545
Interes i përllogaritur mbi huatë		139,969		68,574
Total		**9,099,841**		**7,020,175**

Afati mesatar i kontratave të huave të Grupit është 37 muaj. Më 31 Dhjetor 2024 vlera e portofolit të lënë si kolateral tek huadhënësit është 1,194,793 mijë Lek (2023: 1,001,972 mijë Lek).
Ne mbyllje te vitit me 31 Dhjetor 2024 Shoqeria është në përputhje me të gjitha marrëveshjet e huadhënësve ndërkombëtarë dhe vendas.

24. Borxh i varur

Shoqëria emetoi në Bursën Shqiptare obligacion të nënrënditur të pagarantuar me interes fiks (kupon) 8% p.a, i denominuar në monedhën Lek me vlerë të nënshkruar të obligacionit 500,000 mijë Lek. Interesat janë të pagueshme çdo 6 muaj në datat 23 Qershor dhe 23 Dhjetor, duke filluar nga data 23 dhjetor 2023.

	Shuma e emëtuar	Maturimi	Interesi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Obligacione	500,000	deri 5 vjet	8%	500,000	500,000
Interes i përllogaritur				889	889
Kostot e emetimit				(5,967)	(7,688)
Totali	**-**		**8%**	**494,921**	**493,201**

25. Detyrime të tjera

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detyrimet e tjera janë si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrime për qira (Shënimi 25.2)	186,351	179,309
Kosto për punonjësit dhe shpërblime të përllogaritura	12,394	34,072
Detyrime të tjera tatimore	30,187	20,757
Të pagueshme ndaj ofruesve të shërbimeve	15,056	12,714
Çeqe të lëshuara për t'u tërhequr	70,347	46,281
Provigjone për çështje ligjore (25.1)	3,369	2,599
Tarifa të tjera konsulence	3,851	3,745
Të tjera	20,778	15,267
Total	**342,332**	**314,744**

25.1 Provigjone për çështjet ligjore:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Gjendja hapëse	**2,599**	**4,053**
Zvogëlime	-	(1,477)
Shtesa	770	23
Gjendja në mbyllje	**3,369**	**2,599**

Provigjonet për çështjet ligjore përfshirë çështjet lidhur me ish stafin është 594 mijë Lek (2023: 594 mijë Lek), klientë 123 mije Lek (2023: 103 mijë Lek), dhe palët e treta 2,652 mijë Lek (2023: 1,901 mije Lek).

25.2 Detyrimet e qirasë:

Më poshtë janë paraqitur vlerat kontabël të detyrimeve të qirasë (përfshirë në 'Detyrime të tjera' në Shënimin 25) dhe lëvizjet gjatë periudhës:

	2024	2023
Më 1 Janar	**179,309**	**121,589**
Shtesa	95,536	149,539
Interes shtesë	13,090	10,987
Pagesa	(76,167)	(69,872)
Fshirje/ Transferime	(15,357)	(20,855)
Efekti I kursit të këmbimit	(7,546)	-
Më 31 Dhjetor	**186,351**	**179,309**

Analiza e maturitetit të detyrimeve të qirasë paraqitet në shënimin 6 (c) iii).

Grupi kishte flukse dalëse totale për qiratë në vlerën 76,167 mijë Lek (2023: 69,872 mije Lek).

26. Kapitali i paguar

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 totali i kapitalit aksionar i aprovuar i Grupit përbëhet nga 73,183 aksione i cili është kapital i paguar me një vlerë nominale për aksion prej 10,000.12 Lek si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024			31 Dhjetor 2023		
	Nr. Aksione	Pronësia %	Mijë Lek	Nr. Aksione	Pronësia %	Mijë Lek
Tranzit shpk	73,183	100%	731,838	-	-	-
NOA Cooperatief U.A.	-	-	-	1	0.001%	10
NOA Holding N.V.	-	-	-	73,182	99.999%	731,828
	73,183	**100.0%**	**731,838**	**73,183**	**100.0%**	**731,838**

Asambleja e Përgjithshme vendosi më 08 Prill 2024 të shpërndajë dividendë nga fitimi i vitit 2023. Shuma e dividendit për aksion ishte 2,880 LEK (2023: Asambleja e përgjithshme vendosi më 30 Mars 2023 të paguajë dividentë) si më poshtë:

	2024	2024	2023	2023
NOA Holdings NV	210,764	2,880	199,567	2,727
NOA Cooperatief U.A	2.88	2,880	2.73	2,727
	210,767		**199,570**	

27. Rezerva ligjore

Dispozitat e Ligjit Tregtar kërkojnë krijimin e një rezerve prej 5% të ardhurave neto të Grupit pas zbritjes së humbjeve të akumuluara nga vitet e mëparshme, derisa vlera e kësaj rezervë të arrijë 10% të kapitalit aksionar të Grupit.

28. Rezerva e këmbimit

Rezerva e këmbimit përfshin të gjitha diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja.

29. Interesat jo-kontrolluese

Tabela e mëposhtme përmbledh informacionin në lidhje me filialin e Grupit që ka interesa te pakices materiale. I.F.J.B NOA sh.a Kosova ka vendin e saj kryesor të biznesit në Kosovë.

	40% 2024	40% 2023
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	32,222	27,898
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	168,754	104,871
Inventari dhe aktive të tjera	610	5,914
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	11,813	16,365
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	7,456	1,897
Tatim fitimi i parapaguar	0	14
Aktive te shtyra tatimore	7	-
Aktivet	**220,862**	**156,958**
Detyrime te shtyra tatimore	-	6
Detyrime te tjera	9,250	11,349
Hua	186,544	132,504
Detyrimet	**195,794**	**143,859**
Aktive neto	**25,068**	**13,099**
Te ardhura	30,561	6,610
Humbje	(3,091)	(8,037)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	**(3,091)**	**(8,037)**
Humbja e alokuar ndaj interesave jo-kontrolluese	**(3,091)**	**(8,037)**
Flukset e parasë nga aktivitetet operative	(67,777)	(116,165)
Flukset e parasë nga aktivitete investuese	(2,408)	(10,385)
Flukset e parasë nga aktivitete investuese	76,200	155,756
Rritje te mjeteve monetare dhe ekuivalente me to, neto	**6,015**	**29,206**

Mbështetja financiare e ofruar për NCI

Gjatë vitit 2024 dhe 2023 Grupi mbështeti financiarisht I.F.J.B. NOA sh.a Kosovë, borxh i dhënë ndaj filialit rezulton në shumën 267,950 mijë Lek. Afati i maturimit të marrëveshjeve të financimit varion nga 36 muaj deri në 60 muaj.

Informacioni gjeografik

	2024			2023		
	Vendi i selise	**Kosove**	**Totali**	**Vendi i selise**	**Kosove**	**Totali**
Te ardhurat	2,616,100	102,593	2,718,694	1,970,333	29,647	1,999,980
Aktive afatgjata	265,269	300,902	566,172	258,478	19,526	278,005

30. Palët e lidhura

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj Grupi ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura si më poshtë:

	2024	2023
Detyrimet në fund të vitit		
Llogari të pagueshme për NOA Holding N.V	-	-
Transaksionet në fund të vitit		
Komisione për drejtimin për NOA Holdings N.V	3,542	3,902
Të drejta shfrytëzimi për NOA Holdings N.V.	2,322	2,558
Shpërblimi i drejtimit të lartë dhe Anëtarët e Bordit	114,102	83,410

Shpërblimi për drejtorët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit përfaqëson shpërblimin e ekipit të lartë të menaxhimit dhe tarifat e menaxhimit të aplikueshme për anëtarët e bordit.

31. Analiza e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve

Tabela më poshtë paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve në bazë të pritshmërisë të Grupit për tu rimarrë ose mbyllur:

31 Dhjetor 2024	**Deri në 12 muaj**	**Mbi 12 muaj**	**Total**
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	967,776	-	967,776
Hua institucioneve financiare	69,544	273,495	343,039
Hua dhe paradhënie klientëve neto	4,806,635	5,996,581	10,803,216
Aktive te tjera	135,792	-	135,792
Tatim Fitimi i parapaguar	-	-	-
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe Aktiv me të drejte përdorimi	-	294,803	294,803
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	31,183	31,183
Aktiv tatimor I shtyrë	17	33,887	33,904
Total aktive	**5,979,764**	**6,629,949**	**12,609,713**
Detyrime			
Grante	22,528	-	22,528
Tatim fitimi i pagueshëm	11,182	-	11,182
Detyrime te tjera	155,981	-	155,981
Detyrime për qira	61,061	125,290	186,351
Hua	3,584,951	5,514,889	9,099,841
Borxh i varur	-	494,921	494,921
Total Detyrime	**3,835,703**	**6,135,101**	**9,970,804**
Neto	**2,144,061**	**494,848**	**2,638,909**

31. Analiza e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve (vazhdim)

31 Dhjetor 2023	**Deri në 12 muaj**	**Mbi 12 muaj**	**Total**
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	833,276	-	833,276
Hua institucioneve financiare	(3,263)	-	(3,263)
Hua dhe paradhënie klientëve neto	3,977,411	4,881,762	8,859,172
Aktive te tjera	155,782	-	155,782
Tatim Fitimi i parapaguar	2,103	-	2,103
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe Aktiv me të drejte përdorimi	-	286,348	286,348
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	17,786	17,786
Aktiv tatimor I shtyrë	-	27,796	27,796
Total aktive	**4,965,309**	**5,213,691**	**10,179,000**
Detyrime			
Grante	12,762	-	12,762
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-	-
Detyrime te tjera	135,435	-	135,435
Detyrime për qira	63,949	115,360	179,309
Hua	2,852,054	4,168,121	7,020,175
Obligacione	-	493,201	493,201
Total Detyrime	**3,064,200**	**4,776,682**	**7,840,882**
Neto	**1,901,109**	**437,009**	**2,338,118**

32. Angazhime dhe detyrime te konstatuara

NOA ka lidhur disa marrëveshje huaje me bankat lokale ku huatë e marra janë siguruar duke vënë garanci portofolin e saj të arkëtueshme, balanca më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 është si më poshtë:

	2024	**2023**
Hua dhe paradhënie klientëve	1,221,715	1,001,972
Total	**1,221,715**	**1,001,972**

Procedura Ligjore

Grupi është përfshirë në disa procese gjyqësore dhe procedura ligjore të cilat rrjedhin nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit. Bazuar në këshillat e brendshme apo të jashtme ligjore, drejtimi mendon se këto procese nuk do të kenë efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar dhe aktivitetin e Grupit.

33. Ngjarje pas dates se raportimit

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që kërkojne dhënie informacionesh shpjeguese ne pasqyrat financiare te konsoliduara.